

GUNNAR SVANE

SI TË LEXOJMË VEPRËN E BUDIT “SPECULUM CONFSSIONIS”?*

I.

Kërkimet e mëparshme në fushën e filologjisë ballkanike kanë synuar të vënë në dukje ngjashmëritë dhe përkimet e shumta që kanë gjuhët e Ballkanit me njëra-tjetrën dhe të cilat së bashku përbëjnë Lidhjen gjuhësore ballkanike ose *Sprachbund*-in ballkanik. Që nga botimi i manualit ende të pazëvendësueshëm të Sandfeldit¹, gjuhëtarët janë përqendruar kryesisht në përshkrimin e ballkanizmave, me ndihmën e teorive tipologjike bashkëkohore dhe me vështrim më të thelluar në mekanizmat gjuhësorë të bilinguizmit (gjuhëve në kontakt). Tashmë e kemi të qartë që ekzistojnë lloje të ndryshme ballkanizmash, që gjuhët ballkanike sillen në mënyra të ndryshme me këto ballkanizma, dhe se ballkanizmat kanë mosha të ndryshme. Në të njëjtën kohë kërkimet e fundit kanë filluar të shfaqin interes të shtuar në historinë e ballkanizmave të veçantë në gjuhët e veçanta ballkanike².

Gjuha shqipe mban një pozitë qendrore në të gjitha këto hulumtime³. Kjo është krejt e natyrshme duke pasur parasysh faktin se shqiptarët kanë jetuar në Ballkan së bashku me grekët para se të vinin atje romakët dhe shumë kohë më parë se sllavët dhe turqit të pushtonin gadishullin. Për dymijë vjet shqipja ka qenë njëra nga “gjuhët në kontakt”; dhe, meqenëse ne tani mendojmë se shqipja më e hershme flitej në një hapësirë mjaft më të gjerë sesa sot, mund të përfytyrojmë me siguri se hapësira e kontaktit mes shqipes dhe gjuhëve të tjera (greqishtes, latino-romanishtes, sllavishtes) ka pasur shtrirje të konsiderueshme.

Botimi kritik i tekstit më të vjetër koherent të njohur deri sot në shqip, *Mesharit* të Gjon Buzukut (1555)⁴, është vërtetuar se ka një rëndësi të madhe jo vetëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe, por edhe në mënyrë më të

* Përkthim nga origjinali anglisht “How to read Budi’s ‘Speculum Confessionis’?” *Studia Albanica*, nr. 1, 1980, f. 121-179.

¹ Sandfeld 1926 (në danisht), Sandfeld 1930 (në frëngjisht).

² Për një vështrim të përgjithshëm mbi gjuhësinë ballkanike, khs. Schaller 1975, Demiraj 1970, 1971.

³ Shih p.sh. Çabej 1970.

⁴ Çabej 1968.

veçantë për studimin e ballkanizmave. Është e qartë tashmë se një rëndësi e tillë mund t'u jepet të gjitha monumenteve të vjetra të gjuhës shqipe. Këto monumente të shek. XVII ende nuk janë publikuar në një formë që të jetë njëkohësisht e arritshme për lexuesin dhe besnike ndaj origjinalit⁵. Lexuesi i sotëm vërtet ndesh në vështirësi të shumta thjesht duke lexuar autorët e vjetër.

Ky artikull përpiket të shtrojë disa parime për leximin e veprës së Budit *Speculum Confessionis*⁶. Vërejtjet tona mbështeten në kopjen që gjendet në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagenit (me siglën: 89, - 266).

II.

Libri u shtyp në Romë nga trashëgimtari i tipografit të famshëm Bartolomeo Zanetti. Autori kishte shtypur edhe më parë libra tek ai. Kjo shtypshkronjë, ashtu si shumica e shtypshkronjave të Italisë, merrej kryesisht me prodhimin e librave dhe botimeve të tjera të shkruara në italisht e latinisht. Karakteret e shtypit dhe kodet ortografike që gjenden në *Speculum Confessionis* të Budit janë rrjedhojë e dukshme e këtij *usus*-i latin-italian. Megjithatë, riprodhimi i teksteve shqip u vuri përpara tipografëve probleme të veçanta, dhe botimet e Budit mbajnë gjurmët e këtyre problemeve në mënyra të ndryshme.

Një gjë pozitive që del nga kjo veprimtari tipografike është se u bënë përpjekje për të rregulluar përfaqësimin e tingujve të veçantë të shqipes duke shtënë në përdorim disa shenja (shkronja) të posaçme. Nga ana tjetër, fakti se tani po botoheshin tekste thelbësore në gjuhën shqipe, zbuloi sakaq nevojën për një normë drejtshkrimore të ngulitur. Është e vërtetë se Buzuku e kishte botuar më parë *Mesharin* e tij të famshëm në vitin 1555, por drejtshkrimi i përdorur aty vështirë se mund të karakterizohet si një normë e mirëfilltë me plot kuptimin e fjalës; dhe mbetet e pasigurt nëse Budi e kishte njohur librin e paraardhësit e tij. Kështu që as autori dhe as tipografët e SC në shqip nuk duket se kishin një normë të gatshme drejtshkrimore që ta ndiqnin⁷ – në rastin e autorit thjesht sepse ajo nuk ekzistonte, dhe në rastin e tipografëve (radhitësve) për arsyen e thjeshtë se ata nuk e njihnin shqipen. Për më tepër, duket e dyshimtë nëse Budi të ketë pasur ndonjë ndikim në vetë procesin e shtypjes –

⁵ Khs. Çabej 1959. Ky autor ka dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi tiparet karakteristike të gjuhës së Budit (Çabej 1966). Vërejtje për fjalorin e tij mund të gjenden te Ashta 1966. Për një vështrim rreth jetës dhe veprës së Budit khs. Historia 1959, Domi 1966. Hollësi bibliografike jepen te Roques 1932¹ dhe Shuteriqi 1976.

⁶ Budi 1621.

⁷ Shuteriqi 1976, 27-28 flet për një traditë shkrimi të shqipes që shkon prapa ndoshta në shek. XIV. Kjo duket të jetë shumë e pasigurt.

përveç faktit, natyrisht, se ishte ai që dorëzoi dorëshkrimin për shtyp. Sido që të jetë, drejtshkrimi i botimit të SC që ne njohim dëshmon se nuk është mbikëqyrrur ose lexuar për korrektim nga ndonjë folës i shqipes.

Thuajse i gjithë libri është shtypur në shkronja korsive. Për sa u përket përmasave, karakteri i përdorur në pjesën kryesore të tekstit mund të krahasohet me atë që sot quhet perlë në tipografinë moderne; vetëm te kokat është përdorur një karakter pak më i madh, që i afrohet shumë tipit minjon të kohës sonë.

Përveç korsivit, në gjithë librin është përdorur tipi roman, por vetëm në citimet latinisht dhe në pasqyrën e lëndës në faqet [11-13]. Për k dhe k, j dhe j, shih në vijim.

Simbolet numerike janë mbajtur në tipin roman. Simboli 8 është përdorur jo vetëm si simbol numëror, por edhe si shkronjë e zakonshme (e barasvlershme me y); edhe si shkronjë e zakonshme ajo është shtypur në tipin roman. Një figurë numerike e përmbysur 3 (dmth. ε) është përdorur gjithashtu si shkronjë e zakonshme (e barasvlershme me z; khs. më poshtë, f. 170); është shtypur kurdoherë në tipin roman.

Shenja e veçantë ξ është vështirë të karakterizohet si e tipit korsiv apo roman. Tri vizat kryesore në majë të shkronjës janë vendosur horizontalisht, por këndet që lidhin vizat si dhe bishti që harkohet djathtas i japin shkronjës një përshtypje se është shkruar në korsive. Kjo shkronjë tejet elegante u përdor për herë të parë në shtypshkrimin e shqipes me rastin e botimeve të Budit (*Dottrina Christiana* 1618) dhe zëvendësoi shkronjën trashanike të përdorur në librin e Buzukut gjysmë shekulli më herët. Shkronja u mor më vonë nga Bardhi e Bogdani në shekullin XVII⁸. Për arsye praktike ne do t'i referohemi kësaj shkronje duke përdorur ξ.

Në fjalët e ndara (në kuptimin tipografik, d.m.th. njësi të shtypura të ndara nga të tjerat me anë të një hapësire, – në praktikë zakonisht: grup fjalësh) në fund të rreshtit është përdorur një vizë ndarëse (–) ashtu si në shtypshkrimet e sotme. Për të plotësuar rreshtin, shkronjat *a*, *e*, *m*, *n* për arsye estetike janë zgjatur në *a_i*, *e_i*, *m_i*, *n_i*. Por këto zgjatje janë lënë mënjane në qoftë se shkronja ndiqet nga një presje; e megjithatë ka shembuj të ndryshëm rastesh si *Pageonie_i* (118.8). Zgjatjet e shkronjave që referohen këtu ndonjëherë përdoren edhe në mes të rreshtit, pa dyshim për arsye zbukurimi, p.sh. *Amen_i. asctu chiofte* (159.12). Ky është rasti kur një pasazh i caktuar i tekstit mbaron në mes të rreshtit: *tane*. (204.31); por ky rast i veçantë është tejet i rrallë. Shkronjat e përmendura më lart nuk zgjaten kur përdoren në fjalët kyçe në fund të faqes.

Tri shenja pikësimi përshkojnë tekstin më shumë: dy pikat (:), presja (,) dhe pika (.). Pikëpresja (;) nuk përdoret fort (p.sh.1.2 (te koka); 52.30). Përveç

⁸ Khs. Roques 1932¹, 43-44.

pikës që përdoret rregullisht në mbarim të një pasazhi, pikësimi duket se është krejt i parregullt sipas standardeve të sotme. Madje duket e pamundur të vendoset ndonjë marrëdhënie e rregullt midis pikësimit dhe, për shembull, disa togfjalëshave e fjalive të thjeshta. Në interpretimin e tekstit lexuesi i sotëm më mirë të mos e marrë parasysh pikësimin e Budit dhe ta zëvendësojë atë me një pikësim të vetin.

Shenja p është përdorur gjatë gjithë tekstit me kuptimin *për* (parafjalë) dhe *për-* (parashtesë). Shenja e *tildes* është shumë e shpeshtë dhe përdoret (jo krejt me koherencë) për të treguar një *-m* pas një zanoreje: *-uō = -uom*. Aty-këtu *tildja* shfaqet si tregues i një *-n*-je postvokalike para një bashkëtingëlloreje: *ficūdrefe* (= *sikundrëse*), *mūdune* (= *mundunë*) e të tjera si këto. Në citimet nga latinishtja (me shkronja romane) shenja & përdoret shpesh në vend të fjalës *et*, dhe *et cetera* jepet rregullisht &c. Në pjesën shqipe të tekstit gjegjësjë në shkronja korsive & del në fjali të veçanta. Në këto raste ajo nuk tregon një fjalë por sekuencën *e+t*, p.sh. *tvobegiet*, & *vorfenet* (112.4; = *t vobegjet e t vorfënet*, khs. 375.17), *ayo vullendet eamble etebutee Chrifctit*, & *Apostuyet* (339.9; = *e t apostujet*; khs. 339.26), *ficundrefe doligia & kerftenevet* (393.18); = *ligja e t kërshthenëvet*). Siç tregohet nga shembujt e dhënë, kjo shenjë mund të përfaqësojë lidhëzën + nyjen (dy shembujt e parë) ose nyje + nyje. Meqenëse nuk mund të përfytyrojmë që tipografi të ketë pasur ndonjë njohuri për gjuhën shqipe dhe kështu ta ketë kuptuar shkronjën-sekuencë *et* si të barasvlershme me atë latine (dhe në drejtshkrimin e kohës edhe italiane) *et*, duhet të nxjerrim përfundimin se ky përdorim i veçantë i shenjës ka qenë zakon shkrimor i vetë Budit. Kjo duket të jetë një lloj stenografie personale, e riprodhuar mekanikisht nga tipografi.

Përveç këtyre shembujve, alfabeti i përdorur është ai i zakonshëm italian-latin (me disa shtesa), dhe në shtyp janë përdorur si shkronjat e mëdha (kapitale) ashtu edhe ato të vogla. Për shumicën e shkronjave nuk mund të thuhet ndonjë gjë e veçantë. Janë dalluar shkronjat *Aa, Bb, Cc, Dd, Ee, Pp, Ll, Mm, Nn, Oo, V, Rr, Tt*. Shkronjat e vogla *ç* dhe *æ* hasen rastësisht, por vetëm në citimet latine. Jashtë citimeve latine (dhe italiane) shkronjat kapitale *F, H, Q, X* dhe *Z* duket se përdoren vetëm në shënimet e fletëve tipografike në fund të faqeve *recto*; po ashtu *q* e vogël nuk përdoret përveç se në *qualte* (= *kualtë* 382.23). Megjithatë, shkronjat e vogla *f, h* dhe *z* përdoren rregullisht, madje *z* ka një variant me një gjysmë harku djathtas (këto dy variante janë të përndara në mënyrë krejt rastësore). Shkronja *x* e vogël është e rrallë (p.sh. 12.14, 69.27, 172.3, 317.19). Si *u* edhe *v* dalin në të vogla korsive; nga ana tjetër, vetëm njëra kapitale përdoret nga këto të dyja: *V*. Kjo shkronjë kapitale, megjithatë, në disa raste ka një variant grafik të ngjashëm me ypsilonin grek, por me një krah të ngjitur majtas lart (*v*) p.sh. 271.10, 406 (fjala kryesore), 407.1. Shkronja *k* e vogël përdoret si në tipin roman ashtu dhe në korsiv - përndarja duket se është krejt e rastit: khs. fjalën *kësaaaj* të shkruar *kefaay* 145.15. por dy rreshta më

poshtë: *kefaay* 145.17. Zgjedhja midis *k* dhe *k* duket kështu se varet vetëm nga cilat lloj shkronjash mund të gjente tipografi në kutinë e tij. Ndryshimi nuk duhet marrë parasysh në një transkriptim të sotëm.

Disa probleme të veçanta dalin lidhur me shkronjat e vogla që lidhen me shkronjën e madhe *S*. Në fillim të fjalës zakonisht përdoret vetëm *f*: *fduhete* (= *s duhetë*), *femuune* (= *sëmuunë*), por në raste të veçanta ndeshim edhe grafi si p.sh. *skifc* (= *s kish*; 153.18). Shkronja *ʃ* bashkohet në ligaturë me një *i* pasuese: *ficuur* (= *sikuur*) - në të njëjtën mënyrë siç bashkohen *f* + *i* në *fi*: *fijll* (= *fill*). Në pozicion fundor përdoret *s*-ja: *as*, *mos*, *cias* (= *čas*); kur ndahet fjala tipografike në fund të rreshtit mund të dalë *f*: *af-* (142.14, 213.8), *mbaf-* (177.6) etj. Brenda fjalës tipografike *f*-ja duket të jetë shenja e parapëlqyer zakonisht: *vecefe* (= *veçëse*), *pyefe* (= *pjesë*), *efaaduor* (= *e saa duor*). Rregulla e thjeshtë: *s* në pozicion fundor, përndryshe *f*, thyhet vetëm në pak raste. Kombinimi *ʃc* është tejet i shpeshtë: (= *sh*, pra *shk*): *kifc* (= *kish*), *afcte* (= *ashtë*), *ʃruom* (= *shkruom*) - por në pozicion pas *f*, parapëlqehet *sc*: *cafscce* (= *kafshë*); pa dyshim për arsye estetike, meqë *f* + *f* është vështirë të kombinohen në një ligaturë. Për të njëjtën arsye *f* + *t* nuk bashkohen në ligaturë, dhe në vend të tyre përdoret *st* (e shtypur si një ligaturë si *ct*). Më në fund, *s* përdoret rregullisht në *pse* (= *përse*).

Dyfishimi i shkronjave është i zakonshëm me grupet bashkëtingëllore si *rr*, *ll*, *çç* (grafi si *mefcctijm* - *me shtiim* (303.16) duhen parë si gabime shtypi). Në secilin rast të veçantë duhet vendosur përmes krahasimesh me format e sotme nëse kundërvënja *r* : *rr* është më shumë se thjesht grafike apo nëse grafia pasqyron një dallim në cilësinë fonetike.

Zanoret dyfishë janë të zakonshme: *aa*, *ee*, *uu*, *88* dhe *oo* qëndrojnë për zanore të gjata, të dallueshme nga ana sasiore nga zanoret gjegejse të shkurtra. Në tekst nuk kemi gjetur asgjëkundi grafinë *ii*. Në vend të kësaj, zanorja e gjatë është shkruar me *ij* në një ligaturë që ngjan si një *y* por me një fund të rumbullaktë dhe me një dierezë: *ÿ* (te *y*-ja e zakonshme këmba e majtë dhe e djathtë takohen në një kënd të mprehtë). Megjithatë, kjo ligaturë shihet shumë shpesh të alternohet me *ij*, që do të thotë: *i* korsive e ndjekur nga tipi roman *j* (pa ligaturë). Nuk është e mundur të gjendet një parim i qartë për përndarjen e këtyre dy grafive, meqenëse ato dalin shpesh në të njëjtën fjalë, p.sh. *ketij* ose *këtii* (= *këtii*). Ky dallim duhet lënë mënjanë në një transkriptim të sotëm.

Theksat nuk janë përdorur në tekstin shqip. Grafi të veçanta si à 342.22, è 253.27, 299.6 me shumë gjasë janë thjesht gabime shtypi dhe nuk kanë të bëjnë me konvencionet grafike të përdorura më vonë nga Bogdani.

III.

Nuk ka probleme për identifikimin e tingullit *a*, i cili në drejtshkrimin e Budit shkruhet rregullisht *a*. Një *a* e theksuar del p.sh. në *efyallene* 40.7 (= *e fjalënë*), *cafscene* 89.4 (*kafshënë*), *nate* 121.20 (*natë*). Një *a* paratheksore gjendet në *memofu ngarcuom* 70.5 (*me mos u ngarkuom*), *ndeeacon* 228.22 (*ndë zakon*), *ngažegn8em* 302.31 (*ngadhënjyem*) etj., ndërsa *a* pastheksore haset në fjalë si *tedereyta* 98.10 (*të dërejta*), *tmirave* 193.14 (*t mirave*), *puna* 321.8 (*puna*).

Shndërrimi *a : o*, karakteristik i disa të folmeve gege (lindore), nuk është vërejtur në SC. Ndoshta ky zhvillim i përket një date më të vonë. Është e vërtetë se ka disa shembuj, p.sh., me *tho* në vend të *tha* te Buzuku; interpretimi i këtyre shembujve të veçuar, gjithsesi, mbetet i pasigurt⁹. Ndërsa lidhur me të folmet e sotme të vendlindjes së Budit, krahinës së Matit, çdo *a* gojore apo hundore në kontekst me një bashkëtingëllore hundore është zhvilluar në një [ʌ], e cila nga Beci jepet si *â*. Drejtshkrimi i Budit nuk dallon ndonjë gjë të këtij lloji. Po kështu SC nuk shfaq ndonjë prirje për të riprodhuar shqiptimin e një zanoreje të mesme [ä] ose [æ] karakteristike për të folmet e sotme të Matit¹⁰.

Zanorja *o* në të gjitha pozicionet përfaqësohet nga *o* në drejtshkrimin e SC. Ajo është e theksuar në fjalë si *lemofcene* 44.2 (*lëmoshënë*), *etefchiochit* 179.6 (*e të shoqit*), *eatgnia* 278.12-13 (*zotnja*). Një *o* e patheksuar paratheksore del në *vobecijneevet* 10.1 (*vobeziinë e vet*), *medobitune* 93.5 (*me dobitunë*), *confsecruomit* 303.4 (*konshekrumit*). Kjo zanore është e rrallë në pozicion pastheksor: *cohot* 10.6 (*kohot*), *eteffohotite* 35.11 (*e të ffohotitë*), *fciohone* 10.2 (*shohonë*) e të tjera si këto. Për alternimin *ë ~ o*, khs. më poshtë, f. 17. Ne nuk kemi mundur të sigurohemi për ndonjë ndërrim *o > a* ose *u* që vërehet në pozicion të patheksuar në të folmet e sotme të Matit (*oborr > aborr*; *kopil > kupil* e të ngjashme me to)¹¹.

Budi përdor shenjën 8 për zanoren *y*, e cila në këtë mënyrë është e lehtë për t'u dalluar. Ajo del vetëm në rrokjet e theksuara: *at8* 72.11 (*aty*), *l8pune* 145.12 (*lypunë*), *evet8t* 268.12 (*e vertyt*). Drejtshkrimi nuk zbulon asgjë që të tregojë shqiptimin e këtij tingulli që të jetë [ø], siç e njohim nga të folmet e sotme të Matit, as [ö], që e dimë nga Guri i Bardhë, fshati i lindjes së Budit¹².

Në shumicën dërmuese të rasteve është e lehtë të identifikohet zanorja *u* në drejtshkrimin e Budit - ai shkruan *u* në pozicione të theksuara: *duhene* 54.7 (*duhenë*), *urçene* 349.12 (*urdhënë*), *mbuçete chiellet* 289.8 (*mb udhë-të qiullet*) - si dhe në pozicione të patheksuara: *urate* 251.19 (utarë), *bulmetee* 92.21

⁹ Çabej 1968, I, 68-69.

¹⁰ Beci 1962, 241-423. Vërejtje dialektologjike gjenden gjithashtu te Ulqini 1961.

¹¹ Beci 1962, 249.

¹² Beci 1962, 251-251.

(*bulmete e*), *murtaar* 98.31 - *egrabitune* 145.9 (*e grabitunë*), *efyetulleze* 145.25 (*e sjetulle cë ose e sjetullet së*), *bucura* 358.10 (*bukura*). Megjithatë, në atë kohë, konvencionet drejtshkrimore latine-italiane ishin ende të paqëndrueshme, dhe si *u*-ja si *v*-ja përdoreshin për të dhënë [u]-në dhe po ashtu edhe [v]-në. Këtu mund të theksohen disa prirje kryesore. Roques pohon se dallimi midis *v* dhe *u* i përdorur në fjalorin e Bardhit (1645) është me natyrë thjesht tipografike, ku *v* vendoset më shumë në fillim të fjalës dhe *u* në trup të fjalës, të dyja me vlerë zanoreje dhe bashkëtingëlloreje¹³. Një prirje e ngjashme mund të ndiqet në tekstin e Budit, por megjithatë shenja *u* në SC zakonisht qëndron për zanoren (edhe në fillim të fjalës; khs. shembujt e cituar më lart), ndërsa *v* parapëlqehet për të dhënë bashkëtingëlloren. Në fakt, një *v* e përdorur në fillim të fjalës për *u* (në përputhje me rregullën tipografike të vërejtur te Bardhi) nuk është aspak e zakonshme në SC. Vetëm rastësisht hasim në grafi si *vbaa* (*u baa*), *vngjill* (*ungjill*) e të tjera si këto. Grafi si *Vça* 13.12 (*udha*), *Vcu* 100.25 (*uku*) ose edhe *V chyet* 123.16 (*uqet*) i detyrohen thjesht faktit se shkronja kapitale *U* nuk përdoret fare. Si pasojë drejtshkrimi deri diku i paqëndrueshëm i SC nuk shkakton vështirësi reale për të lexuar e kuptuar tekstin - duke lënë mënjanë konsideratën nëse në disa pozicione mund të ketë qenë shqiptuar një gjysmëzanore bilabiale. Për këtë alternim [u] ~ [w] (u), khs. më poshtë, f. 165-166.

Si rregull, SC e jep zanoren *i* me anë të shkronjës *i*. ajo është e theksuar në: *liçune* 54.9 (*lidhunë*), *epsihete* 74.27 (*e përzhitetë*), *giççe ditee tyera* 250.20 (*gjithë ditë e tjera*), - paratheksore në: *ndefit8ret* 100.21-22 (*ndë fityrët*), *etuendumuom* 164.10-11 (*e tue ndimuom*), *eelatricoyne* 276.9 (*e e latrizojnë*), - pastheksore në: *mesferierfcim* 120.20 (*mëshëriershim*), *maampari* 165.11 (*maampari*), *mbe truollit* 303.25 (*mbë truollit*).

Dëshmi të pakundërshtueshme kemi gjetur për një alternim midis zanores [i] dhe gjysmëzanores [i̯]. Kjo rrethanë, si dhe lëkundja grafike midis shkronjave *i*, *j* dhe *y*, karakteristike për kohën, e turbullojnë pamjen. Për më tepër, shkronja *i* e përdorur në kombinimet tejet të shpeshta *chi-*, *gi-*, *ki-* zotëron funksione që nuk kanë të bëjnë aspak me zanoren (shih më poshtë). Gjithashtu, sequenca *ij* me raste shkruhet edhe *y*: *3otenyä* (*zotënija* ose *zotënija*) e të tjera. Por megjithatë, tabloja e përgjithshme mbetet e qartë.

Nuk kemi gjetur dëshmi të zhvillimit $i > e$, që është karakteristikë e dialektit të Matit dhe që llogaritet të jetë i një moshe të madhe¹⁴.

Për sa i përket *e-së*, kjo është shkronja më e vështirë në drejtshkrimin e Budit sepse ai nuk bën dallim mes zanoreve *e* dhe *ë*; që të dyja këto shkruhen njësoj *e*.

¹³ Roques 1932¹, 45.

¹⁴ Beci 1962, 243 vv.

Në hyrjen e tij të botimit kritik të *Mesharit* të Buzukut (1555) prof. Çabej ka dhënë disa udhëzime sipas të cilave mund të dallojmë *e*-në dhe *ë*-në e patheksuar kur lexojmë një tekst në gegërishten e vjetër kur këto kanë vetëm një shprehje ortografike¹⁵. Këto parime mund të zbatohen edhe në SC.

Nuk ka probleme dallimi të *e* nga *ë* në kontekste si: *mete pefciuomite tereijvet* 144.6, *faa afcte ende paa precune* 219.21-22, *eempfcijne pgiççanescit, poficuur eogoria euchiet gnie Delle tevetemene* 255.16-18, *afcte fciaam ebelbeuō* 339.1. Si toskërishtja ashtu dhe gegërishtja përmbajnë një *e* të theksuar në *ende* (*enne*), *prekur* (*prekun*), *dele*, *vetëm* (*vetëm*). Si toskërishtja ashtu dhe gegërishtja kanë një *e* të patheksuar në *peshoj*, *terezi*, *belbëz* (*belbëz*), - *ende* (*enne*), *ujqvet*. Shkronjat e tjera *e* në citimet nga SC duhen vlerësuar se shënojnë *ë* përdërisa në dialektet e sotme ato ose kanë rënë ose janë ruajtur si *ë* (të paktën në dialektet arkaike periferike). Që këtej ne mund të jemi krejt të sigurt se citimet e mësipërme duhen transkriptuar (lexuar) kështu: *me të peshuomi-të tereziivet*, - *saa ashtë ende paa prekunë*, - *e e mpshiinë për gjithë anëshit posikuur zogoria e uqet një dele të vetëmenë*, - *ashtë shaam e belbëzuom*.

Në shqipen e veriut (gegërishte) statusi i *ë*-së është mjaft i paqartë. Në pozicione të patheksuara ajo del vetëm sporadikisht në raste të veçanta dhe disi të diskutueshme. Në pozicion të patheksuar thjesht është zhdukur në shumë raste, ose ka mbijetuar si një zanore e shkurtër e tipit *schwa*. Zakonisht shkruhet *ë*, por shqiptimi duket se jepet në mënyrë të përshtatshme si [ə], megjithëse ka dëshmi edhe për një *e* të nyjëtuar lirshëm, të paktën në disa pozicione të caktuara; ndonjëherë shkruhet *ë*¹⁶. Por të gjitha këto, dhe veçanërisht rënia e *ë*-së, kanë lidhje vetëm me dialektet e sotme. Tekstet e botuara nga autorët e vjetër gegë (dhe midis tyre SC) janë shkruar sipas konvencioneve drejtshkrimore që tregojnë se *ë*-ja ishte ende e paprekur në shumë nga ato pozicione ku tani është zhdukur - madje edhe në rastet kur zanorja ka rënë relativisht herët edhe në shqipen e jugut (toskërishte). Përgjithësisht mbahet se ka qenë Bogdani i cili në fund të shekullit XVII bëri përpjekjen e parë në gegërishte për të diferencuar *e*-në nga *ë*-ja (d.m.th.: *ë*)¹⁷. Është e njohur përgjithësisht se Buzuku dhe Budi, ashtu si dhe bashkëkohësi i tyre Bardhi, përdorën shkronjën *e* për të dy tingujt.

¹⁵ Çabej 1968, I, 69-70.

¹⁶ Pekmezi 1908, 7; 50. Për shqiptimin e *ë*-së, khs. Dodi 1970, 57-59.

¹⁷ Bogdani 1685. Përdorimi i theksit të rëndë (*accent grave*) në librin e Bogdanit duhet riparë. Në fakt ai përdor këtë theks edhe mbi zanoret e tjera, dhe një pjesë e mirë e grafive të tij *ë* duket se qëndrojnë për *e* (dhe jo *ë*). - Midis shkrimtarëve që përdorin dialektin toskë, Matrënga ishte i pari që përdori një shkronjë të veçantë për tingullin *ë*: *æ*, në librin e tij *Dottrina Cristiana* (1592).

Për sa i përket pozicionit të theksuar, kemi vënë në dukje tashmë se nuk ka diskutim për identifikimin e një *e*-je të theksuar në rastet kur zanorja është etimologjikisht e qartë dhe mund të vërehet ende drejtpërdrejt në dialektet e sotme. Por vështirësi dalin lidhur me *ë*-në e theksuar. A ka ekzistuar vërtet ajo në gegërishten e vjetër?

Zanorja *ë* e theksuar është e shpeshtë në toskërishte. Fjalët gjegjëse të gegërishtes përmbajnë një tingull hundor *â* ose *ê*, dhe në raste të tilla nuk mund të ketë dyshim se një tekst i vjetër si SC nuk do të ketë pasur *ë*. Por ka probleme me kallëzoret e përemrave (*a)tê, kêtë, kë*. Format gjegjëse të veriut zakonisht jepen si (*a)tê, ktê, kê* në shumicën e rasteve; por jemi të informuar nga dialektologët se ekzistojnë edhe format që përmbajnë një *ë* (të shqiptuara me një nuancë të lehtë *o*-je në Dibër, për shembull)¹⁸. Tani, duhet supozuar se këto forma të shoqëruara me një ndryshim theksi (në *âtê, kêtê*) duhet të kenë qenë kushti për format e apokopuara si *at, kët*. Arsyeja e këtij rrëgjimi të zanores nga *ê* në *ë* dhe e ndryshimit të theksit me sa duket ka qenë se përemrat në fjalë në fakt nuk ishin të theksuar; brenda togfjalëshave emërorë ato pas gjase theksoheshin dobët ose ishin fare pa theks. Kjo, natyrisht, nuk mbetet veçse një hamendje. Kështu ne duhet të pranojmë se grafitë e Budit: *ate, kete, te* janë të paqarta. Autori nuk tregon asnjëherë ku duhet vënë theksi, as thotë ndonjë gjë për hundorësinë; prandaj janë të mundshme lexime të ndryshme, p.sh.: *kêtê, kêtê, kêtê*. Tani, në 308.10 gjejmë *mbatt cias* dhe duket e natyrshme ta lexojmë këtë si: *mb at ças*. Është e vërtetë se ky shembull duket të jetë i izoluar. Por, në qoftë se vërtet përfaqëson më shumë se një tjetër gabim shtypi të zakonshëm (për fat të keq ka shumë gabime shtypi pak a shumë të dukshme në SC), duket krejt e natyrshme ta interpretojmë një grafi të tillë si dëshmi që gjuha e Budit ka (ose më mirë: mund të ketë) forma të theksuara nistore të tipit përemëror në fjalë. Prandaj ne do të parapëlqejmë t’i lexojmë kallëzoret dëftore dhe pyetëse në SC si *atê, kêtê, të*. Siç është e njohur, kjo është pikërisht zgjedhja e zbatuar nga botuesi në përfaqësimin e formave gjegjëse në *Mesharin* e *Buzukut*¹⁹.

Ndërsa për numërorin dhe përemrin *një*, i cili zakonisht gjendet në lidhje me *ë*-në e theksuar²⁰, në SC Budi përdor jo vetëm *gnie* por edhe *gni, gnia*. Është jashtë diskutimi që këto të jenë thjesht gabime shtypi. Përkundrazi, këtu kemi të bëjmë me një alternim të papenguar midis formave të ndryshme që ende përdoren në të folmet e veriut: ato zakonisht kanë *nji*, por në disa vende në vend të saj përdoret *nja*, p.sh. në të folmet malësore²¹. Format e shquara përkatësisht *njëni* dhe *njëni* (në SC *gniani*) i takojnë kësaj kategorie. Fakti që

¹⁸ Çabej 1973, 88.

¹⁹ Çabej 1968, I, 69.

²⁰ Çabej 1968, I, 69; 1973, 89.

²¹ Pekmezi 1908, 264.

kjo fjalë përmban ose mund të përmbajë një *ë*, pas gjase ndodh ngaqë ajo në fakt është e theksuar dobët ose madje krejt e patheksuara. E njëjta arsye ndoshta mund të jepet për alternimet e shpesh të formave si *aqë/aqi*, *mbë/mbi*, *që/qi* në tekstin e Budit.

Problemi i vërtetë është si të dallohen rastet në të cilat *e*-ja e Budit në një rrokje të patheksuara përfaqëson një *e* nga ato ku e njëjta shkronjë duhet lexuar dhe transkriptuar *ë*. Gjithsesi disa raste janë relativisht të thjeshta. Kur fjalë të tilla si *arrefshe*, *fayetuor*, *petecu*, *scperese* krahasohen me format e sotme: *arsye*, *fajtor*, *petku*, *shpresë*, është e qartë se përfaqësimi në SC duhet transkriptuar: *arrësye*, *fajëtuor*, *petëku*, *shpëresë*. Forma si *kifce*, *kifcfe* interpretohen lehtë si *kishë*, *kishësë* – e para ende sot formë e gjuhës standarde (edhe pse *ë*-ja shpesh bie, sidomos në shqipen e veriut), ndërsa e dyta gjendet vetëm në dialekte toske arkaike (e rrudhur në *kishës* në gjuhën standarde). Konteksti sintaksor si rregull do të vendosë nëse një *kifce* duhet marrë si emërore-kallëzore *kishë* apo si gjinore-dhanore-rrjedhore *kishe*, – ndërsa *nevojfcime* përfaqëson një trajtë mashkullore ose femërore: *nevojshimë* ose *nevojshime*, e kështu me radhë. Konteksti tregon nëse *-ene* është forma veprorë *-ënë* apo mediopasive *-enë*. Mbaresa që dalin rregullisht si mediopasivi *-etë* ose pjesoret më *-unë* janë të lehta për t'u dalluar, edhe kur sot ato njihen vetëm në dialektet më arkaike apo kanë dalë nga përdorimi fare.

Vështirësia kryesore në dallimin e *e*-së dhe *ë*-së së patheksuara qëndron në zakonet e Budit dhe të autorëve të vjetër gegë për të bashkuar fjalët sipas parimeve që për lexuesin e sotëm duken disi ekscentrike, për ta thënë me të butë (nëse vërtet mund të flasim për parime të mirëfillta). Për shembull, sequenca *te* mund të jetë lidhëz, nyje ose përemër, dhe në atë rast duhet lexuar *të*. Ose mund të jetë vetëm një fragment i një grupi fjalësh të shkruar bashkë ose të ndarë gabim: *terrete*, *te rrete* (që të dyja përfaqësojnë: *t errëtë* “errësirë”). E gjithë kjo, krahas prirjes për rënien e një zanoreje *ë* të patheksuara, e ndërlikon shumë çështjen e leximit dhe transkriptimit në një alfabet të sotëm në një numër rastesh – veçanërisht në shembuj ku gjenden nyjet shquese enklitike të prapavendosura ose nyjet proklitike të paravendosura.

Ne e dimë me siguri se edhe në kohën e Budit zanorja *ë* ishte e prirur të binte, sidomos në pozicione fundore. SC gëlon nga shembuj në të cilët zanorja ka rënë. Forma si *ta*, *ti*, *tu* janë kombinime të lidhëzës ose përemrit *të* dhe formave përemërore *e*, *i*, *u*. Kës. edhe rrëgjimin e lidhëzës në kombinime si *mbarrefsete ndoognij chitis fcomunicuom* 4.16 (*qi t ish*). Nyja *të* rrëgjohe rregullisht në *t* para një zanoreje. Përveç *terrete* që cituam më lart, shembujt pasues do të shërbejnë si ilustrime të përshtatshme: *nde giuhutane tarbenefce* [1.4] (*t arbëneshë*), *evente krefcmeje etangienimit* 330.29 (*t angjënimit*), *nder chifcdo caffce, tudoba ete vogela* 344.28 (*t udoba*). Kjo nyje e rrëgjuar po ashtu përdoret mjaft shpesh para një bashkëtingëlloreje – veçanërisht, kështu duket, në rastet kur *t* që mbetet përthithet në një fjalë paraardhëse që mbaron me

zanore. P.sh. *ilane giurmeteechristit éte Apostuyet, eveperatee tkerftenevet, envefcne nderte tPeganevet, etetpaafeevet* [1.26-2.2] (*i lanë gjurmëtë e Krishtit e të (sic!) apostujet e vepratë e t kërshtenëvet e nveshnë ndër të t pëganëvet e të t paafeevet*). Në mënyrë të ngjashme ka një alternim midis *mbë, mbi* para një bashkëtingëlloreje, *mb* para një zanoreje, – *që, qi* plus bashkëtingëllore, *q* plus zanore. Shkurtesa *p* (për latinishten *per*) përdoret rregullisht me kuptimin *për(-)* para një bashkëtingëlloreje; përpara një zanoreje rrëgjohet në *pr* dhe shkruhet kështu: *prata (pr ata), premenit (pr emënit)* etj. Të gjitha këto flasin për statusin e paqëndrueshëm të zanores në të gjitha këto pjesëza krejtësisht të patheksuara. Për më tepër, ne mund të jemi të sigurt se një *ë* në fund të fjalës ka qenë shpesh pazane edhe nëse Budi e shkruante atë. Në poezinë e tij, ku ai gjithmonë përdor një metër prej tetë rrokjesh, vërejmë se një *ë* jo medoemos llogaritet në një numër rastesh, – p.sh.

Efcperefe pte fcelbuom (404.26)
e shpëresë për të shelbuom
 1 2 3 4 5 6 7 8

Enderte barçat mirefilli (405.9)
e ndër të bardhat mirëfilli
 1 2 3 4 5 6 7 8

Kech içune efarmacuom (406.25)
keq idhunë e farmakuom
 1 2 3 4 5 6 7 8

Nate edite tuefcruom (407.31)
natë e ditë tue shkruom
 1 2 3 4 5 6 7 8

Në një numër fjalësh toskërishtja ka *ël, ër* përpara një bashkëtingëlloreje: *shëlboj, shërbej, vërtetë, vërtyt* e kështu me radhë. Format gjegjëse të gegërishtes ruajnë një tingull i cili sipas Pekmezit shqiptohet si një *ë* e shqiptuar çlirët: *shelboj, sherbej, vertet, vertyt* (ose *virtyt*)²². Gjendja duket se ndryshon nga rasti në rast dhe gjithsesi ne nuk mund të dimë si kanë qenë shqiptuar saktësisht fjalë të tilla në shek. XVII. Meqenëse zanorja nuk elidohej edhe pse ishte jashtë theksit, ne parapëlqejmë ta transkriptojmë atë *e* në shembuj si: *fcelbuom, fcerbet8re, ptevertete, vert8tya (shelbuom, sherbëtyrë, për të vërtetë, vertyja)*. E bëjmë këtë thjesht për hir të koherencës, edhe pse kështu u shmangemi parimeve të shtruara nga Çabej në transkriptimin e tekstit të Buzukut (*sherbëtyrë por vërtetë*)²³.

²² Pekmezi 1908.

²³ Çabej 1968, I, 69.

Shembujt e Budit *vend*, *fcemellet8re*, *fcemptuom* e të tjera si këto ne i transkriptojmë si: *vend*, *shemëllëtyrë*, *shemptuom* e kështu me radhë, sepse këto fjalë përmbajnë një *ê* hundore në gegërishten e sotme, khs. *vend*, *shemëllty'r*, *shem(p)toj*, *tremb* (*tremi*) etj. Forma si *vënd*, *shëmbëll* (*-bull*), *trëmb* janë tipike për toskërishten krahas *vend*, *shembëll*, *tremb*, nga të cilat kanë rrjedhur. Gjuha standarde tani po përpiqet ta rregullojë përndarjen e këtyre dubleteve: *shemb*, *shembull*, *tremb* të theksuara – por p.sh. *shëmbëllej*, *shëmbëllim*, *shëmbëllesë*, *shëmbëlltyrë* në pozicione të patheksuara. Megjithatë, udhëzuesi më i ri i drejtshkrimi²⁴ nuk është krejt i qëndrueshëm: *vend* e theksuar parapëlqehet ndaj *vënd*, por *e*-ja kërkohet edhe në rrokje të patheksuara: *vendos*, *vendbanim*, *vendlindje*. Megjithatë, atje ku toskërishtja ka vetëm *ën*, *ëm* ndërsa format gjegjëse geqe e bjerrin krejt zanoren: *shëndet*, *shëndosh* – *shndet* (*shnnet*), *shndosh* (*shnnosh*) – ne mendojmë se gjuha e Budit e kishte ende *ë*-në e patheksuar: *fcendet* (*shëndet*), *fcendofce* (*shëndoshë*) e të tjera si këto. Në emrat e shenjtorëve si *ifcen Bernaardij* 306.9, *fcem Pietre* 42.26, 399.4, *ifcemehilli* 404.13, *ptefcene merijne* e kështu me radhë ne pëlqejmë të lexojmë *shën* (*shëm*, *shë*-), *shënë* që u përgjigjen të sotmeve *Shën Gjon*, *shën Pali* (*Shpali*). Pavarësisht nga fakti që gegërishtja e sotme ka gjithashtu *shên*, *Shên Kollit*²⁵, ne parapëlqejmë *ë* në këtë rast, sepse e shohim *shën* etj. si forma *allegro* tipike, meqë forma normale e theksuar e kësaj fjale të veçantë në SC është *shint*, fem. *shinte*. Fjala e huazuar *shëndërtat*, *sh(ë)ndritat* (*sh(ë)nnritat*) (nga latinishtja e vonë *sancta- trinitate*-) është rrëguar mjaft. Budi ka *cendrijtat* 29.23 etj., e cila duhet transkriptuar *Shëndriitat*. Për një ndikim të mundshëm nga *shëndrit* (*shëndris*) dhe *dritë*, khs. vërejtjet etimologjike të Çabejt²⁶.

SC përmban shumë fjalë të huaja. Disa prej tyre janë futur në tekst thjesht në formën e tyre origjinale: latinizma si *proprie*, *coram*, *caufa*, italianizma si *bestialtà*, *confideratione* (grafia *-zione* tani e zakonshme nuk ishte standarde në shek. XVII). Fjalë të tjera ishin pas gjase pak a shumë të natyralizuara në shqipe, të paktën në tekste diturore si SC. Në këto raste grafia nuk është krejt koherente, gjë që duket se pasqyron prirjen e tyre për të qenë huazime të zakonshme. Kjo ndodh për shumë nga emrat abstraktë më *-tie*, *-die*, *-nie* e të tjera si këto: *reverentie*, *malitie*, *confscientie*, *obedientie*, *remedie*, *cerimonie* etj. Grafi të rastit si *ofizie*, *fententie* e kështu me radhë zbulojnë shqiptimin e vërtetë të fjalëve më *-tie*. Sa për vlerën e *e*-së, nuk mund të jemi të sigurt nëse ka qenë *-e* ose ndoshta *-ë*. Në raste të tilla Çabej parapëlqen *avaricie*, *glorie*, *paciencie*, *patrie*²⁷, dhe kjo është ndoshta rruga e drejtë që duhet ndjekur. Budi

²⁴ Kostallari 1976.

²⁵ Fjaluer 1978, 417.

²⁶ Çabej 1976¹.

²⁷ Çabej 1968, I, 70.

ka format gjegjëse të shquara: *fakerfitia* 135.1, *fentenzia* 386.12 e kështu me radhë.

Për sa i përket realizimit të *ë*-së së patheksuar vërejmë në gjuhën e SC një dukuri shumë interesante, shndërrimin e saj në *u* ose *o*. Për sa kemi dijeni, ky shndërrim nuk është vënë re më parë në lidhje me gjuhën e Budit; gjithashtu shndërrime të tilla zanoresh nuk janë vënë re në gjuhën e autorëve të tjerë të vjetër gegë. Shndërrimin *ë* > *u* e gjejmë në shembuj si: *pn dimete giuhufe Arbeneſce* (façja e titullit) (*për ndimë të gjuhës arbëneshë*); *giuhutane* 136.29, [1.3] (*gjuhu tanë*); *giuhunevet* 110.13 (*gjuhunë e vet*). Një shndërrim i ngjashëm *ë* > *o* del të jetë më i shpeshtë: *mbegureteftohote* [4.4] (*mbë gurë* (dmth: *gurrë*) të *fthotë*); *ete fthotite* 35.11 (*e të fthotitë*); – *tagnioho* 186.7 (*ta njoho*); – *Cohote* 47.30 (khs. 83.25, 91.22 etj.) (*koho të*); *nde cohote* 10.6 (khs. 41.29 etj.) (*ndë kohot*); *oonde chifmot e coho* 20.15 (*oo ndë qish mot e koho*); *taſcti motne e cohone e kie* 24.19 (*tashti motnë e kohonë e kie*); – *ſcioho* 28.19, 74.4 (*shoho*); *ſcio hone* 10.2, 55.4 (*shohonë*); *ſcihoneſe* 10.8-9, 67.17, 81.2 etj. (*shohonë se*) e të tjera si këto. Shembuj të këtij lloji janë caq të shumë përgjatë gjithë SC saqë është jashtë diskutimi t’i shpjegosh ato si gabime shtypi. Nëse *ë* shndërrohet në *u* apo *o* kjo varet nga cilësia e zanores në rrokjen paraardhëse: *ë* > *u* pas një rrokjeje që përmban *u*, – *ë* > *o* pas një rrokjeje që përmban *o*. Ky tip shndërrimi zanoresh, që mund të quhet një lloj harmonie vokalike, përshkon gjithë librin dhe mund të konsiderohet tipik për gjuhën e autorit. Natyrisht kjo dukuri duhet ruajtur në një transkriptim në alfabetin e sotëm. Nuk është pa rëndësi këtu se *koho* në vend të normales *kohë* është vërejtur si një tipar karakteristik i dialektit të Elbasanit²⁸, dmth. lloji i gegërishtes së folur në rajonin në jug të krahinës së Matit, ku kishte lindur Budi.

IV.

Ka qenë praktikë e të gjithë autorëve të vjetër gegë të shënojnë gjatësinë e zanoreve me dyfishimin e shkronjave: *aa* [a:], *uu* [u:] etj. Kjo mënyrë shkrimi nuk ka qenë shumë koherente, por megjithatë tepër e shpeshtë edhe te Buzuku (1555). Në përputhje me drejtshkrimin e tij *Meshari* i tij u transkriptua dhe u riprodhua me këto shënime të gjatësisë që ekzistonin në tekstin origjinal, dhe në botimin e tij kritik Çabej është përpjekur të përcaktojë kur drejtshkrimi shpreh saktësisht gjatësinë reale të zanores (*gjā, jū, mī* e të tjera) dhe kur kemi

²⁸ Pekmezi 1908, 251. – Cipo flet për këtë dukuri si asimilim progresiv në gramatikën e tij (1949) dhe citon *gjuhu, koho* (dhe *numur, bukusë*) me referim te Naim Frashëri (Cipo 1949, f. 12-13); ai nuk e lokalizon dukurinë në Elbasan. Në *Mesha e shën Jon Gojartit* e Dhaskal Todhrit nga Elbasani (shek. XVIII-XIX) gjejmë shprehje si *më koho të gjaame, më xhdo koho e vend* (Shuteriqi, 1955, f. 58-59).

shembuj të dy tingujve identikë të ndarë nga një hiatus (*Abraam, Betleem, Booz* etj.)²⁹. Me gjithë vërejtjet e Roques³⁰ për faktin se nga fjalori i Bardhit (1635) del se ai nuk ka dijeni për veprën e Budit, është krejt e qartë se drejtshkrimi i Bardhit është më i afërti me atë të Budit. Bardhi gjithashtu shënon gjatësinë e zanoreve me anë të dyfishimit të shkronjave (*me baam; sßß* etj.), edhe pse me një dozë të madhe moskoherence. Sa për Bogdanin, shënimi i gjatësisë së zanoreve prej tij në veprën *Cuneus Prophetarum* duket se është i rastësishëm, për të mos thënë kaotik.

Midis gjithë autorëve të vjetër gegë Budi është në fakt ai që e shënon gjatësinë e zanoreve me koherencën më të madhe. Meqenëse bashkëkohësit e tij nuk njihnin një normë të ngulitur drejtshkrimore, kjo koherencë e tij është vërtet e shënueshme. Shkaku i kësaj vështirë se mund t'i detyrohet vetëm kujdesit me të cilin përgatiti Budi dorëshkrimin e tij për shtyp. Për më tepër, radhitësit romanë, që nuk e dinin shqipen, nuk kishin gisht në vendimet drejtshkrimore që u morën. Një shpjegim më i natyrshëm për këtë koherencë lidhur me shënimin e gjatësisë së zanoreve mund të gjendet në faktin se forma, ose, po të duam, dialekti i veçantë i shqipes që përbën bërthamën e gjuhës së Budit, bën një dallim më të qartë midis zanoreve të shkurtra e të gjata nga ç'ishte karakteristike për gjuhën e autorëve të tjerë veriorë. Nuk mund të themi saktësisht se nga e morën autorët shqiptarë të shekujve XVI e XVII praktikën e shënitit të gjatësisë së zanoreve duke shkruar zanore dyfishë. Të gjithë ata (me përjashtimin e mundshëm të Bardhit) pa dyshim e njihnin serbo-kroatishten, e cila gjithashtu dallon zanoret e gjata nga të shkurtrat; por edhe këtu dyfishimi i shkronjave zanore nuk ishte një kod i ngulitur drejtshkrimor i kohës. Zanoret e dyfishuara po ashtu nuk njiheshin për shënimin e gjatësinë në shkrimet latinisht e italisht.

Sidoqoftë ne duhet të përfytyrojmë se ishte pikërisht drejtshkrimi italian i kohës që nxiti shqiptarët të shkruanin zanoret e gjata me shkronja dyfishë. Dyfishimi i shkronjave për të treguar të ashtuquajturat bashkëtingëllore të gjata, geminate ishte dhe është ende i përhapur gjerësisht në italisht. Se kur e morën saktësisht shqiptarët idenë për ta mbartur këtë parim drejtshkrimor të zanoret, këtë nuk e dimë. Vetëm mund të pohojmë se shkronjat e dyfisha zanore së pari u shfaqën te Buzuku (1555) dhe se Matrënga po ashtu përdori të njëjtin parim me shumë koherencë në katekizmin e tij toskërisht (1592).

Për të dhënë gjatësitë e zanoreve të gegërishtes së vjetër në një transkriptim modern nuk është aspak pa probleme. Siç e kemi përmendur më parë, Çabej zgjodhi të ndjekë traditën albanologjike dhe të shkruajë *ā, ī, ŷ* etj. por të mbajë *aa, ii, oo* etj. në rastet kur ai mendonte se atje kishte një hiatus.

²⁹ Çabej 1968, I, 65. Për një diskutim të kuantitetit të zanoreve të parë në këndvështrim historik, khs. Çabej 1957.

³⁰ Roques 1932¹, 34-35; por khs. f. 41.

Por në të njëjtën kohë editori nuk e fsheh faktin se ka edhe raste të dyshimta, p.sh. *barī* ose *barii*, *nierīt* ose *nieriit*. Gjithashtu duket se ka disa moskoherenca në transkriptimin e dhënë: në *lee atē* “dimitte illam” Çabej shkruan *ee* sepse kemi të bëjmë me urdhëroren *le* + përemrin *e*; por ai shkruan *epēnī* “date huic” edhe pse kemi gjithashtu një urdhërore *epēni* + përemrin *i*³¹. Gjithsesi, këto janë moskoherenca që në praktikë nuk janë shumë shqetësuese. Megjithatë, duhet bërë e qartë se ne nuk jemi në gjendje të themi saktësisht se si i kuptonte vetë Buzuku zanoret e gjata në raste të tilla.

Me Budin puna qëndron ndryshe.

I detyrohemi Lacajt për një analizë metrike të poemave në veprat e Budit³². Ai ka përcaktuar se një varg tetërrokësh është përdorur me shumë rregullsi – një fakt që mund të vërtetohet me anë të vargjeve:

Egnye yete forte giate

E një jetë fort e gjatë

1 2 3 4 5 6 7 8

Sceculline tapuctognye (404.13-14)

Shekullinë t a puçtonjë

1 2 3 4 5 6 7 8

Tani, del se, kur haset një shkronjë zanore dyfishe (dmth. një zanore e gjatë) në një varg të tillë, poeti e numëron atë si dy rrokje:

Chi eot88ne teyape (404.9)

qi Zotynë të japë

1 2 3 4 5 6 7 8

Etetyera Regienij (404.17)

e të tjera regjēnii

1 2 3 4 5 6 7 8

Mbeaa tue ççirre t88 (406.9)

mb zaa tue thirrë tyy

1 2 3 4 5 6 7 8

Eeaane tem ndegiome (407.19)

e zaanë tem ndëgiomë

1 2 3 4 5 6 7 8

Kedorayote ivuu (406.20)

ke dora jote i vuu

1 2 3 4 5 6 7 8

³¹ Çabej 1968, I, 65.

³² Lacaj 1966.

Nga ana jonë ne jemi të prirur ta konsiderojmë këtë si një tregues të fuqishëm se duke mbajtur shkrimin e dyfishtë në një transkriptim të modernizuar dhe më lehtë të lexueshëm të SC ne i afrohem shumë të kuptuarit të vetë autorit për natyrën e zanoreve të gjata. Është e vërtetë se duke vepruar kështu ne jemi në shkelje të parimit që dallon *ā* nga *aa* të zbatuar nga editori i tekstit të Buzukut. Por kjo vështirë se do të përbëjë një problem të vërtetë. SC ka p.sh. *Abraamit* 369.23-24, dhe në transkriptim kjo do të duhet të mbahet e pandryshuar dhe për këtë arsye do të jetë e dykuptimtë. Por në fund të fundit edhe *Abraami* i Buzukut ndoshta është i dykuptimtë. Mundet që ai përfaqëson, siç supozon Çabej, dy zanore *a* të ndara nga një hiatus – një interpretim që mund të mbështetet nga *Abrahami* e Bardhit, ku *h* është marrë pa dyshim nga latinishtja *Abraham* por nuk shqiptohet. Nga ana tjetër, duke gjykuar nga drejtshkrimi *Abrami*, i hasur shpesh te Bogdani (p.sh. I.I.III. 3-4 dhe në rreshtat vijues), ka të ngjarë se ky emër shqiptohet me zanore të gjatë edhe nga autorët e tjerë të vjetër.

Për sa u përket zanoreve të gjata të theksuara po japim më poshtë një listë të gjerë shembujsh për të treguar se deri në ç’pikë Budi e shënon gjatësinë duke përdorur shkronja dyfishe. Një *aa* e theksuar del në një numër të madh leksemash foljore, p.sh. *baa* (*chif vbaa vbaa* 349.6 *qish u baa, u baa*), *baakii* (*eyu posciofsee baakij, fcpellenee cufarevet* 49.22 *e ju po shof, se e baakii shpellënë e kusarëvet*), – *mbaajtunë* (*mbaaytune*; shumë e shpeshtë; gabim shtypi: *maaaytune prafgiaa nyerij* 63.19); – *ngaam* (*mepunuom oome ngaam chiete* 395.6 *me punuom oo me ngaam qetë*); – *u ngjaall* (*vngiaall po ficuurte chieneke tuefytune* 315.17 *u ngjaall posikur të qenëke tue fjetunë*); – *pëgaam* (*kech peg aam* (sic!) *emendr8em* 405.24 *keq pëgaam e mendryem*); – *raam* (*Amos kifcgnie... luoytune nvalle... oo raamfellit* 48.3 *A mos kishnje ... luojtunë n valle... oo raam fellit?*); – *vdaaretë* (*ememofelane tevdaarete* 110.1 *e me mos e lanë të vdaaretë*); – *vraake* (*saadote vraake, çotefe mcat fkaa* 66.31 *saado të vraake, thotë se mkat s kaa*); – *xaamë* (*kezaame keincelgnyeme f88te skemi* 351.1 *ke xaamë e ke i nçelnjëmë syytë s kemi*). Një *aa* e theksuar shfaqet në mbiemra si *ifcengion goyaartij beecuõ* 232.26 *i shën Gjon Gojarti i beekuom*, – *nze maaymi, enzelaenuomi* 20.29 *ncë majmi e ncë lazënuomi*. Një numër i madh emrash përmbajnë një *aa* të theksuar: *cundra arrefeut, oocundra aantefse t8ne* 241.28 *kundra arrëseut oo kundra aantësë tyne*, – *plot me lule emebaar* 392.26 *plot me lule e me baar*; – *gjaa* “gjah”: *evete pgiaÅ, vecese ndechie giaÅ yanatene* 47.29 *e vete për gjaa, veçëse ndë qe gjajja natënë*; – *gjaa* “gjë, send; çështje”: shumë e shpeshtë qoftë si e veçuar *giaa* qoftë në kombinimin *giaa cafsce* (*gjaakafshë*; ndoshta e patheksuar)³³, – *Amos kifcgnie*

³³ Mbetet e pasigurt nëse drejtshkrimi i veçantë *giaÅ* për “gjah, gjueti” është menduar për të qenë i ndryshëm nga *giaa* “gjë, send”. Gegërishtja e sotme ka përkatësisht *gjaa* dhe *gjâ*; trajtat e shquara: *gjaja* - *gjâja*.

çane cund gaa huaa 90.26 A mos kishnje dhanë kund gaa huaa (tani hua, gegërisht uhaa); – emete hiecone posicuur caallinee zgjebete mbas vetehei; 229.29 e me të hjekunë posikuur kaalinë e xgjebëtë mbas vetëhej; – tuemos vuom roe traaneemaç 262.14 tue mos vuom roe traanë e madh. Me shumë rregullsi përdor Budi emrat në -aar, -taar: Confesinaar (gabim shtypi) [3.17] konfessionaar, – fedigetaar 19.2 fëdigëtaar, – margallitaar 319.1-2, Margallitaar 209.10-11 margal(l)itaar, – tregetaar 19.1 tregëtaar e kështu me radhë. Gjatësia ruhet në kallëzoren e shquar njëjës më -rrë (< -r-në): muor Pendene ecalamaarre [6.23] muor pendënë e kallamaarrë, – mete dametuom vistaarree Regienijse chiellet 231.29me të damëtuom vistaarrë e regjëniisë qiullet (khs. 287.4), – emeyçane litaarre 381.24 e me j dhanë litaarrë. Megjithatë, gjatësia lihet mënjandë kur zanorja del në rrokje të hapur: evefctetari i plagevet ey mengijvet 19.1e veshëtari i plagëvet e j mëngjiivet, – evefctetare ndergiççe 128.2 e veshëtare ndër gjithë, – tedegniete lavdit tineëot e proniaretee Regienijse chiellet 154.4-5 të denjëte e lavdit Tinëzot e proniarëtë e regjëniisë qiullet, – oome Engiellinee tineëot chi afcte ftraëetari8t 261.28 oo me engjëllinë e Tinëzot, qi ashtë shtraëetari yt. Khs. edhe (m(p)cat) murtaar, por në shumës: murtare.

Një ee e gjatë në rrokjet rrënjore të theksuara duket shpesh në SC. Ndër format foljore mund të përmendim epte cpbleemitane 30.15 e për të çpërbleemi-tanë (khs. 110.1, 113.19), bleegniene 377.6 bleenjënë; – ndeëune ekendellune 383.31 ndezunë e këndellunë (lhs. 388.3); – fedoraiote podomeu ndeem 240.26 se dora jote po do me u ndeem; – ndeer ditee deell sic! 44.24 ndeer ditë e diell³⁴. Emri ndeer gjendet si vijon: endeme damptegiaaefe ete ndeerfevet 340.24 ende me damp të gjaasë e të ndeersë vet, – dignitatnë endeerrefciume 364.1 dinjitatnë e ndeerrë e shumë; – eafgnie fiale prata ferreecaa 320.24 e asnjë fjalë pr ata s e rrekaa; khs. mbiemrin gjegjës në etregetij terreescime 340.14 e tregëtii të rreeshime; – posicuur tikiçc ççëerune, emb8tune me duortevet 70.12 posikuur t i kish theerunë e mbytunë me duor të vet. Format mbiemërore e përemërore: nzeete e kendellune 388.3 nxeetë e këndellunë; – mee, tee (krahas meeje, teeje), nee dhe neesh përdoren rregullisht gjatë gjithë tekstit. Emrat me një ee të gjatë përfaqësohen nga p.sh. at8 ndeëeete huoy [4.9] aty ndë dheë të huoj, – pmbijçëet 227.4 pëmbii dheet (por: ete driatune teçeut 78.21 e të dridhtunë të dheut); – ficuurcaaliijpaafree 173.16 sikuur kaali j paafree (por: pfreni 374.14. për freni); – Myeek 18.28 mjeeek, shumë: Tep8etunitëe Myechiet 141.13 të pyetunitë e mjeeqet; – maametemaçëeell efcperëfe 341.15 maa me të madh zeell e shpëresë (po ashtu:

³⁴ Budi shkruan gjithmonë e diell (sot: e diel) dhe diell(i). Edhe Bogdani ka e diel (dmth. e diell). Bardhi shkruan: Dies Dominicus / Dita e Diel, por drejtshkrimi i tij është i paqëndrueshëm, khs. Diabolus/Diali (në vend të: djaalli).

leellfcim); – *oobapti steerreerij* 395.21 *oo baptisteerrë e rii*; – *nde prandeveeret* 392.20 *ndë prandëveerët*, – *mepulchieert* 224.29 *me pulqeert*. Ndryshimi nga *ee* në *rrokje* të mbyllur në *e* në *rrokje* të hapur dëshmohej gjatë gjithë librit nga fjala e përdorur shpesh (*i*)*lter*, forma të së cilës janë, p.sh., (*i*)*lterit*, (*i*)*lterë*.

Siç u përmend më lart, SC nuk përdor asnjëherë *ii* – në vend të saj një *ii* e gjatë shkruhet *ij*, ndonjëherë madje *y*. Shembuj të *ii* të theksuar në rrënjë të fjalës janë p.sh. *mbeij bana mee fctampon* (sic!) [2.29] *mbzii bana me e shtampuom*; – *dergon, eep, do termete... e eijneemaçe* 78.23 *dërgon e ep do tërmete.. e ziinë e madhe*; – *chifc mos telefcte, ooteçijne* 292.28 *qish mos të leshtë oo të dhiinë*; – *trii* (fem., por pasaktësisht *trihere* 135.21 në vend të *trii here*); – forma foljore: *mee delijrm* 23.24 *me e dëliirm*; *emeedelyrone* 120.6 *e me e dëliurunë*; – *kemune mberij gnienne* 220.28 *ke munë mbërrinjënë*; *ay taberrijgnie* 222.16 *aj t a mbërrinjë* (khs. 255.16, 360.27 e kështu me radhë); – *eembfcijne pgiççanefcit* 255.16 *e e mpshiinë për gjith anëshit*; – *tue pijm* 50.6-7 *tue piim*. Emra me *ii* të theksuar në trup të fjalës: *biir* – *Ambeson mbeotnee fscendrijtat, Atene, e bijrre, efcpijrtinefcint* 29.23 *A mbeson mbë Zotnë e Shëndriitat: Atënë e Biirrë e Shpiirtinë shint?*; *tedafciunine bijrrevet* 195.14 *të dashuninë biirrë e vet*; *tedafciunine byrreefaay* 278.18 *të dashuninë biirrë e saaj* (por forma e shumësit është e pasigurt: *tebiytee atit* 280.18 *të biijhtë/bijhtë e atit*); – *defcijr* është grafia e zakonshme e *dëshiir*, por *defcyr* 11.4; – *fijll* në togfjalëshin e përhershëm *teanefijll* e të tjerë si *ky*, për shembull 163.13 *të zanë fiil*; – *mevdyerre hijrree tineot* 193.9 *me vdjerrë hiirrë e Tinëzot*; – *mijeafluuratefe* 230.19 *miiza fluuratefe* (khs. 135.8); – *fcpijrt* është grafia e zakonshme e fjalës shumë të shpeshtë *shpiirt*; në 55.21 është shkruar *pscpyrtit* për *për shpiirtit*; – *etefcintit vngijll* 363.6 *e të shintit ungjil* (por në rrokje të hapur: *enaurçenon vngilli* 350.26-27 *e na urdhënon ungjilli*). Një grup shumë i madh emrash mbarojnë më *-ii*, i cili ruhet gjatë lakimit përpara një bashkëtingëlloreje. Shumica e tyre janë femërorë. Ndër to bëjnë pjesë mes të tjerash (po i citojmë të transkriptuara): *fantazii, godii, hullii (huullii), lakëmi, maskarii, pleqëni, rakii, regjëni, shintëni, shoqëni, terezii, trazii, tregëti, zogorii, zotëni*. Emrat vetjakë të burrave dhe të grave i takojnë të njëjtit tip: *Ilii, Malakii, Mërii*. Në të gjitha këto fjalë forma e shquar mbaron më *-ia*: *eogoria* 255.17 *zogoria*. Një tjetër tip më *-ii* janë rrënjët mashkullore më *-n*: *mii* – *ete pgioniene, poficuur mazamijne* 252.12 *e të përgjonjënë posikuur maca miinë*; – *Mërtii* – *otit scen Mertij* 328.21 *zotit shën Mërtii*; – *sultii* – *egnie fultij tevetemine* 283.2 *për një sultii të vetëminë* (khs. 292.4, 292.5; shumësi: *nzuor d8sultign* 282.20 *nxuor d8 sultinj*).

Fjala *bari* (*bariu*), shumësi *barinj* në SC përfaqësohet nga *baarij* 19.3, 138.20 *baarii* me zanore të gjatë të rrënjës; format e saj të lakuara kanë zanore të shkurtër: *bariu* 75.14, 150.31, *bariut* 91.16. Shumësi gjegjës është *bruo*, i cili haset shpesh përgjatë gjithë tekstit: *bruo* 335.29 (si përkthim nga latinishtja

pastores) *bruote* 152.4 *bruotë* (khs. 335.10, 334.7, 337.15), *bruovet* 123.17 (148.18, 334.28, 351.29, 399.19), *bruofcit* 147.13 *bruoshit* (154.10, 335.1). Në studimet e tij etimologjike Çabej ka gjetur një lidhje mes këtyre dy formimeve³⁵. Sipas shpjegimeve të tij, *barí* është një emër më i ri kolektiv më - *i* (në zanafillë femëror, më vonë i singularizuar si mashkullor), i rrjedhur nga folja *bar*. Që formimi duhet të jetë relativisht i ri, kjo dëshmohet nga fakti se *barí* ka ruajtur *a*-në e tij – e cila mund të ketë qenë e gjatë (khs. formën e Budit *baarii*). Si gjegjës të *bruo*-s në SC mund të gjejmë *bëruo* që përdoret në një rast të vetëm në tekstin e Buzukut me një zanore të dobët të rrënjës ende të ruajtur si *ë*. Çabej e shpjegon fjalën *bëruo* si “bariu”, që nuk duket të jetë shumë e saktë. Forma e Buzukut në fakt është një përkthim nga shumësi *puerosque*, ndërsa Budi e njej *bruo*-n vetëm si formë shumësi. Duket se kemi të bëjmë me një lakim të vjetër supletiv: njëjës *ba(a)rii*, shumës *b(ë)ruo*.

Një yy e gjatë e theksuar del në fjalën *dryy* “dry”: *uacaa fctijm eemerene ndr88 69.5 u a kaa shtim zemërënë n dryy*; khs. edhe *Eyd88yti Dr88 iparrijfit 276.4 e j dyyiti dryy i parriisit* e kështu me radhë. Forma gjegjëse e shumësit është *dryenë*: *Dr8e nefcize chiellet 13.13 dryenëshit së qiellet* (khs. 274.28, 274. 30; *Dr8ene*). Për theksimin, etimologjinë dhe kuptimet e kësaj fjale, khs. vërejtjet e Çabejt³⁶. Numërori *dy* ka një zanore të shkurtër në trajtën e mashkullores: *oocuurte duoyte, gniani, oote d8 meu cinguō 84.20 oo kuur të duoj njani oo të dy me u kunguom*, – por trajta e femërores është *dyy*: *med88 Motra 74.31 me dyy motra (med8etrij fyale 21.26 me dy e tri i fjalë* me gjasë është shkruar gabim). Fjala *d88fiefc 65.2 dyyfiesh* dhe numërori rreshtor *dyyjtë* (i shkruar rregullisht *d88yt-*, por *ed88ta 120.6*) gjithashtu hyjnë këtu. Emri *g88ch* (*gjyyq*) e ruan gjatësinë e zanores: *g88chit* e të tjera si kjo (me grafi të gabuar *gr88chi 66.24*). Mjaft shpesh haset fjala *s88* (*syy*), e cila gjithashtu e ruan gjatësinë e saj në forma të ndryshme: (gabim shtypi: *888teetuu 81.1 syytë etuu*); me të ka lidhje *meynce lej88se 9.26 me j nçelë syyzë*.

Shembuj me *uu* të gjatë të theksuar: *aneze kruufse [4.3] anet së Kruusë*; – *puna chite mos diheey, feecuuya afcte 90.7 puna, qi të mos diheej, se kuujja ashtë*; – *bucurte vuumroë (sic!) 19.19 bukur tue vuum roe* (shumë e shpeshtë); – *kecuune me mbleeruom 392.25 ke zuunë me mbleeruom*; – *maamire memuum megjellune 393.7 maa mirë me muun me gjellunë* (por: *mundune (mundunë)*); khs. *ifemuni 142.8 i sëmuni*. Fjala “uri”: *megnetemaç defcijr, ete eeellfcime uum te fcpijrtit 172.1 me një të madh dëshiir e të zeellshime uum të shpiirtit* – por: *gniete maç defcijr euute fcpijrtit 175.30 një të madh dëshiir e uu të shpiirtit*.

³⁵ Çabej 1976², 165-167; 214-215.

³⁶³⁶ Çabej 1976¹, I, 145.

V.

Duke hulumtuar gjatësinë e zanoreve në *Mesharin* e Buzukut (1555) Çabej vërejtë se fjalët tek të cilat zanoret në rrethana të zakonshme jepen si të gjata, nganjëherë shkruhen me një shkronjë të vetme. Ai mendon se në këto raste nuk kemi të bëjmë me gabime shtypi, por se drejtshkrimi i tij pasqyron faktin e fonetikës sintaktike se gjatësia e zanoreve shpesh rrëgjohet në pozicione të theksuara dobët në togfjalësha dhe fjali³⁷. Duhet pranuar se këtu ndodhemi në terren të lëkundshëm. Me një tekst të vjetër disa qindrvajçar ne nxjerrim përfundime lidhur me intonacionin e fjalisë dhe humbjen e mundshme të theksit vetëm duke projektuar shprehitë e ligjërit të sotëm në kohë të shkuara. Kjo në vetvete është e vështirë mjaft. Për më tepër, edhe përdoruesit e sotëm të gjuhës kanë idiosinkrasitë e veta, sidomos kur është fjala për tekste tipike letrare, diturore ose publicistike si SC. Megjithatë, vëzhgimi i Çabejt është i rëndësishëm, dhe përfundimet e tij në parim mbeten të arsyeshme dhe bindëse.

Deri në ç'shikallë mund të vërehet diçka e ngjashme në tekstin e Budit, kjo mbetet për t'u parë. Tani për tani mund të themi me siguri vetëm se nuk ka të ngjarë që një humbje e tillë e gjatësisë së zanores (qoftë dhe brenda kufijve të një fjale apo fjalie të vetme) të vërtetohet në shtrirje të gjerë. Arsyeja për këtë është e thjeshtë: midis autorëve të vjetër Budi është ai që respekton më me skrupulozitet rregullin e shënimit të zanoreve të gjata duke dyfishuar shkronjat zanore. Pavarësisht nga kjo, megjithëkëtë duhet të pranojmë se fjalët e shkurtra/pjesëzat nganjëherë shqiptoheshin me zanore të shkurtra. Këtë e dimë nga metrika e Budit. Krahas shembujve si:

Emefaa tekemb8em (406.28)

e me saa të këmbyem

1 2 34 5 6 78

Mefaa mpcate pçee (406.20)

me saa mpkate për dhee

1 23 45 6 78

ku *saa* llogaritet si dy rrokje, gjejmë edhe

Efaandere maatenalte (404.11)

e saa ndere maa të naltë

1 2 3 4 5 6 7 8

Maate ndritçime se 8lli (4-5.11)

maa të ndritshime se ylli

1 2 3 4 5 6 7 8

³⁷ Çabej 1968, I, 65-66.

Ku që të dyja *maa* dhe *saa* llogariten si një rrokje secila dhe duhet të kenë qenë të dyja të shqiptuara me zanore të shkurtra, pavarësisht nga shkrimi. Natyrisht, kjo duhet mbajtur parasysh kur gjykojmë kuantitetin e zanoreve në pozicione të patheksuara.

Budi ka një *aa* të patheksuar në fjalë si: *caadaleçepngee* 14729 *kadaledh e për ngee* (khs. 150.10); – *mevotë ncaaluor nde Parrijsit* 240.2. *me votë nkaaluor ndë parriisit* (khs. 369.16); – *Cunoretee Rgianda ete praaruome* 318.8 *kunorëtë e rgjanda e të praaruome*. Fjalë të vogla si *maa*, *paa* (parafjalë dhe parashtesë), *saa* ne supozojmë se janë përherë të patheksuara, por shkrimi është i rregullt dhe shmangiet nga ky rregull janë të rralla – p.sh. *mai vogelli* 14.27 *ma i vogëli*, – *fyale te pangiaana* [4.21] *fjalë të pangjana (poa rref8em* 4.31 është ndoshta një gabim shtypi i zakonshëm për *paa rrëfyem*). Gjithashtu supozojmë se fjalë si këto janë të patheksuara: *cahamunëççomi* [8.25] *kaha munë thomi*, – *maa caar fetifcte, maivogelli* 14.26-27 *makaar se t ishte ma i vogëli* (khs. *macaar* 124.22). Pa dyshim *aa* është e patheksuar në pseudohaboret si *chienencaa* [3.23] *qenëkaa*, – *fjueanecaa* 326.24 *s u përzanëkaa*, – dhe *caa* e shkruar rregullisht kështu është pas gjase pak a shumë e theksuar dobët ose madje krejt e patheksuar në kombinime si *ndoogniecot chi caapuctet* 18.24 *ndoonje zot qi kaa puçtet*, – *je ndoognie caa8em derene* 87.14-15 *se ndoonjë kaa thyem derënë*, – *maateperecuur yucaafale eayfcaadafc mei responduom* 105.13-14 *maa tepërë kuur ju kaa falë e aj s kaa dash me i responduom*.

Format mediopasive më *-eesh*, *-eej* shkruhen gjithmonë në këtë mënyrë edhe pse përmbajnë një *ee* të patheksuar: *afroneesh* 253.13, *gjindeesh* 82.15, 223.3, *mpshteteesh* 221.21, – *diteej* 90.7, *rrekumendoheej* 315.13 e kështu me radhë. Ka femërore në rrjedhore më *-ee* të patheksuar: *rrezee* 407.16; – forma foljore si *jee* 82.15, 223.2, *jeetë* 86.14 etj. mendojmë se janë në përgjithësi të theksuara dobët. Në togfjalëshin e qëndrueshëm *vee ree/roe*, që haset shpesh gjatë gjithë tekstit, duhet supozuar se *vee* ka qenë shpesh e patheksuar, përderisa më vonë u rrëgjua në *ë* ose edhe ra fare në foljen e prejardhur *vërej vrej*³⁸. Një *ee* e patheksuar gjendet në folje si *tuleenognie pak oo sciume anzo mundimefc* 371.8-9 *t u leenonjë pak oo shumë anco mundimesh*, – *euune me mbleeruom emeu mbufciune giççe plot melule* 392.25 *zuunë me mbleeruom e me u mbushunë gjithë plot me lule*. Për foljen e sotme *pengoj* (geg. *pëngo*) gjejmë: *paandognie tieter tepeenguom* 276.16 *paa ndonjë tjetër të penguom*. Budi shkruan *ee* në foljen *qel*: *fesia chieelle afctu liëçune ppara Pilatit* 255.25 *sesi a qeellë ashtu lidhunë përpara Pilatit*, – *Amos kifcgnie chieellune çune* 98.1 *A mos kishnje qeellunë dhunë?... – epbucune, echieel çuune* 342.29 *e përbuzunë e qeell dhuunë*.

³⁸ Çabej 1976¹, II, 304.

Në një numër rastesh të veçanta gjejmë në SC një *ee* që nuk mund të interpretohet në mënyrën e zakonshme. Fjala që i përgjigjet së sotmes *njeri* nuk shkruhet asnjëherë me *gn-* (*nj-*) por më së shumti *nyerij*, *nierij* që do të thotë: *n'jerii*, *nierii*. Krahas kësaj gjejmë një grafi *nyerij*, e cila është mjaft e shpeshtë që të mos merret si gabim shtypi i zakonshëm; ajo mund të jetë refleksi i diçkaje karakteristike për shqiptimin dhe drejtshkrimin e autorit. Zanorja është po aq e vështirë për t'u shpjeguar sa edhe zanoret në *d88temira bascke memofo mpyeecune* 343.28 *dyy të mira bashkë me mos i mpjekunë, – keebredr8fccu eegerbeeya* 227.4 *ke e bre dryshku e zgjerbeja* (përkatësisht e theksuar dhe e patheksuar).

Budi normalisht ka *mberr-* në foljen që i përgjigjet të sotmes *mbërrij* (geg. (*m*)*rrij*), por përveç se ka shembuj të ndryshëm me *mbeer-*, si p.sh. *mbatehere cuur temoficne ende mbeerrijm, mbemotchidologia meu marre oognianitifc mberijm etyeteri yo* 85.22-23 *mb atë herë kuur të mos ishnë ende mbërrim mbë mot, qi do ligja me u marrë, oo njani t ish mbërrim e tjetëri jo; – poirralli eypacu caameya mbeerrijm* 217.31 *po i rralli e j paku kaa me j a mbërrim; – yacaa mbeerrijm, oocameya mbeerrijm* 239.21 *j a kaa mbërrim oo kaa me j a mbërrim* (khs. edhe p.sh. 325.24, 346.7, 349.7, 360.27). Krahas *meng-* gjejmë edhe *meeng-*: *psëata epe ndoone meengoffcine nderdifacaffce, posigind emitune, ... aspak sduhete me meenguom na* 152.1-4 *përse ata e se ndoonë mëngofshinë ndër disa kafshë posi gjind e mitunë, ... aspak s duhetë me menguom na*. Këtë folje ne e marrim si identike me *mungoj* (e formuar nga *mang*; *mangut*; khs. togfjalëshin e qëndrueshëm *asgiaamangu* (*asgjaamangu*), geg. *mëngoj*, *mungoj* (Bashkimi). Folja e sotme *rrënoj* (*rrenoj*) geg. *rrënoj*, gjithashtu shkruhet me *ee* në tekstin e Budit: *feu rreeuo, eurreenuo giççe reççijfcecullit* 389.20 *se u rrëzuo e u rrenuo gjithë rrethi i shekullit*.

Grafia *ee* në këto raste vështirë se ka qenë një zanore e gjatë. A është e mundur që Budi të ketë dashur të japë një zanore të shkurtër, të rrëgjuar, ndoshta madje *ë* me anë të kësaj grafie të veçantë? Që *ee* mund të jetë përdorur vërtet për *ë*, arsyetohet nga fjali si: *at8 ndeeçete huoy* [4.9] *aty ndë dheë të huoj*. Vallë *nyerij* mund të merret si një përpjekje për të shkruar *niërii*, e cila ndoshta ishte stadi që do të çonte në të sotmen *nëri*?

Një *ii* paratheksore haset në shembuj si: *ete lijrogn* 24.29 *e të liironj, – fscendrijtat* 40.22 *Shëndriitat*; zanorja është pastheksore në pseudohabitore si *eyu posciofsee baakij fspellenee cusarevet* 49.22 *e ju po shof, se e baakii shpellënë e kusarëvet, – endyere mptafcti cuchienekij* 202.10 *e ndjerë tashti ku qenëkii?*

Ka një *uu* të patheksuar në fjalë si *chiene cuuynaay, detuor* 56.28 *qenë kuujnaaj detuor, – mijëa fluuratëse, – fluuron evete nde Parrijfit* 276.16 *fluuron e vete ndë parriisit*. Në togfjalëshja si *nder f88tetuu* 262.15 *ndër syy të tuu, – ecuurtedoe* [1.11] *e kuur të doe* kemi të bëjmë pas gjase me *uu* të theksuar dobët ose të patheksuar.

Nuk kemi vërejtur shembuj me *yy* në pozitë të patheksuar.

Në përgjithësi një *oo* e gjatë është e rrallë. Ajo përdoret në pasthirmën *oo(h)*. Përemri i pacaktuar është shkruar rregullisht *ndoognie* (*ndoonjë*), edhe pse duhet të ketë pasur shpesh një theks të dobët (por kemi gjithnjë *ndo... ndo... “ose...ose...”*); e njëjta gjë mund të thuhet për lidhëzat *oo* dhe *ndoonë*. Në disa fjalë duket të ketë lëkundje. Budi ka: *temarme... scoopne ooferratene ndore* 364.30 të *marmë... shkoprë oo ferratënë n dorë* (i njëjti drejtshkrim është përdorur nga Bogdani), por Bardhi shkruan: *Baculus/Scop*, SC ka: *hoostiete* 133.13 *hoostietë*, – *d88 hoostie* 133.19 – por: *hostiet* 133.9, *Hofsteia*. Budi ka një zanore të gjatë në: *sciume efaaduor Roobesc* 153.22 *shumë e saa duor roobësh*, por dy rreshta më tej: *Robete*. Një drejtshkrim i ngjashëm i paqëndrueshëm haset në: *giucuum mbe Moort* 139.11 *gjykuom mbë moort*, por në rreshtin 16: *mort*; khs. përsëri Bardhi: *Mors/mortia*, – por në anën tjetër: *Horrenda mors est/Echechie moortia afte*.

VI.

Ishte Meyeri që vërtetoi se diftongu *ua* i shqipes është zhvilluar nga një *o* më e vjetër e shkurtër ose e gjatë përpara bashkëtingëlloreve hundore ose lëngëtore³⁹. Në vitin 1931 Jokli përvijoi një zinxhir zhvillimesh, nga të cilat disa hallka (*uo*, *ua*, *ue*, *ū*) ai mundi t’i gjurmojë në tekstet dhe dialektet e sotme⁴⁰. Mbi këtë bazë Çabej analizoi lëndën e teksteve mesjetare në latinisht dhe në emrat shqip të gjetur në to ai përqendroi vëmendjen në fazën *ou*, e cila konsiderohet se qëndron në bazë të të gjitha rezultateve të këtij zhvillimi⁴¹. Duket se *ou* ekzistonte ende në shek. XV, për t’u zëvendësuar nga *uo*, *ua* gjatë shekullit XVI. Rezultate si *ue* (*uë*), *ū* duket se janë kryer gjatë tre shekujve të fundit.

Pohimi se shqipja e jugut (toskërishtja) ka *ua* ndërsa shqipja e veriut (gegërishtja) ka *ue*, *ū* është e saktë për sa kohë kjo pasqyron një prirje të përgjithshme. Por hulumtime më të imta të kryera kohët e fundit në fushën e dialektologjisë kanë treguar se tabloja është më e ndërlikuar. Sipas Gjinarit *ua* nuk është posaçërisht toske por del edhe në truallin e gegërishtes, p.sh. në Malësi të Madhe (sidomos në Kelmend), në disa të ashtuquajtura të folme kalimtare dhe në disa zona të Kosovës⁴². Grupi *ue* si një rezultat i marrë rregullisht nga *uo* është karakteristik për të folmet e veriut gjatë lumit Drin. Në të folmet që fliten më në jug (midis Drinit dhe Matit) një *-ue* ruhet në rrokje

³⁹ Meyer 1888, 5.

⁴⁰ Jokl 1931, 274 vv., 1932, 33 vv.

⁴¹ Çabej 1958, 134 vv.

⁴² Gjinari 1970, 39; shih edhe Shkurtaç 1975, 25-27.

fundore të hapur, ndërsa diftongu tkurret në *ū* në të gjitha pozicionet në rajonin e Shkodrës dhe në të folmet e gegërishtes jugore (midis Matit dhe Shkumbinit)⁴³.

Të dhëna të besueshme lidhur me fazat e zhvillimit dhe të kronologjisë së tyre është e vështirë të gjenden, meqenëse regjistrimet dialektologjike nga kohët e vjetra janë thuajse inekzistente dhe dëshmitë e autorëve të shekujve XVI-XVII mund të interpretohen në mënyra të ndryshme. Hulumtimet e sotme dialektologjike dhe vëzhgimet fonetike kanë treguar se *ua* e të tjera nuk duhen marrë gjithmonë si diftongje të vërteta por më shumë si grupe zanoresh. Tani, është interesante të vërejmë se në disa dialekte të toskërishtes kemi një grup zanor *-ua* në një rrokje të hapur fundore por një diftong të mirëfilltë në trup të fjalës. Pikërisht të njëjtat kushte pozicionale mbizotërojnë në ato dialekte të gegërishtes që kanë *-ue* fundore kundrejt *-ū* në trup të fjalës⁴⁴. Kjo duket të tregojë një prirje të përbashkët të shqipes si një e tërë. Megjithatë, në gjendjen ku jemi, na mungon lënda që mund të na lejonte të gjurmonim hollësitë e këtij zhvillimi.

Përveç *ua*-së që haset sporadikisht në Kelmend e gjetiu, gegërishtja duket se ka qenë më konservative se toskërishtja përderisa faza *uo* mbizotëronte ende në kohën e Buzukut e të Budit. Megjithatë, në të njëjtën kohë, mund të ketë vazhduar një zhvillim i mëtejshëm në *ue* (ose edhe *uë*), pasi bashkëkohësi i Budit, Bardhi nga Zadrima, e përdorte diftongun në këtë formë; kështu vepronte edhe Bogdani nga Hasi në trojet e gegërishtes verilindore disa dekada më vonë. Budi për shembull shkruan krejt rregullisht *gruo*, *bruo*, *muo*, – *duor*, *kujtuom*, *ruojtunë* etj., kështu që në këtë pikë ai është qartësisht konservativ. Sigurisht shumë më tepër sesa folësit e dialekteve të sotme në rajonin e Matit që kanë *-ue/-ū-* vetëm sporadikisht në anët veriore por e kanë shndërruar më së shumti në *ū* në të gjitha pozicionet. Është pohuar shprehimisht se një *ū* përdoret pa përjashtim në Gur të Bardhë, fshati i lindjes i Budit⁴⁵.

Kështu pra, Budi shkroi *uo*. Por si e shqiptonte ai këtë? Ne nuk e dimë me siguri. Ndoshta ai vërtet e shqiptonte *uo* (një *uo* ende ekziston vende-vende në Malësi të Madhe, Malësi të Krujës)⁴⁶. Ndoshta ai vetëm sa ndiqte një traditë drejtshkrimore të kohës së vet dhe shkruante *uo* por në të vërtetë e shqiptonte atë në një mënyrë që të kujton *ue* (*uë*) ende të pranishme p.sh. në veri të Drinit. Nuk është aspak e padiskutueshme se në rrethana të caktuar ai madje e shqiptonte atë si një *ū* të gjatë. Në disa vende të caktuara SC jep shenja për këtë. Në një rast ne kemi gjetur *endedueteççomfe... 11.6 ende due të thom se...* me një shndërrim *uo > ue* në rrokje të hapur në fund të fjalës. Për më tepër,

⁴³ Gjinari 1970, 39.

⁴⁴ Gjinari 1970, 38-39.

⁴⁵ Beci 1962, 250-251.

⁴⁶ Gjinari 1970, 39.

dalin nga dy raste që tregojnë shndërrimin $uo > u$ në trup të fjalës: *tengreene, durte, etiveene pmbij krðetetij 38.4 të ngreenë durtë e t i veenë përmbii krye të tii* (zakonisht e shkruar *duor(të)*), – *muomechiuogniene Mberfcele emera 310.10 muo më qunjënë Mbërshelëzemëra* (khs. rreshti 17-18: *chiuogniene, 31: mechiuognene – (më) quonjënë*). Natyrisht, këta pak shembuj nuk ofrojnë një bazë të shëndoshë për një argument bindës. Por ato nuk janë medoemos gabime shtypi. Në çdo rast ia vlen të shënohet se përndarja *ue/e* i përgjigjet përndarjes së njohur nga dialektet e sotme midis Drinit dhe Matit. Por në të njëjtën kohë, duhet të pranojmë se do të kishim pritur forma si **duurtë, *quonjënë* me monoftongje të gjata.

Nëse Budi shqiptonte *uo* si një diftong të mirëfilltë apo si grup zanor, nga drejtshkrimi i tij nuk mund të nxjerrim asgjë. Por, pavarësisht si e shqiptonte ai, mund të jemi të sigurt se *metrikisht* ai i numëronte diftongjet si dy rrokje, – khs. *uo* dhe *ye* në shembuj si

Ligfe tuicundrestuom
ligjsë tu i kundrështuom

1 2 3 4 5 6 7 8

Emefaa tekembðem
e me saa të këmbyem

1 2 3 4 5 6 7 8

Pofi uku iterbuom
posi uku i tërbuom

1 2 3 4 5 6 7 8

Ndeerre tanderremðem

Grafi të tilla si *qytë* në vend të *qyetë* janë krejt të izoluara në SC; *chðtehere bie nde mcat murtaar 103.26 qyetë herë bie ndë mkat murtaar*, – rrëfymit në vend të rrëfyemit: *Pafechðra etRefðmit 1.1 Pasëqyra e t rrëfyemit*; ndoshta këto janë thjesht gabime shtypi. Nëse janë të tilla, ato nuk na thonë asgjë për monoftongizimin ($ye > \bar{y}$ në shumë të folme të sotme). Grupi zanor/diftongu *ye* përndryshe ruhet mirë në tekstin e Budit: *arrësye, dryenë, krye, pyetunë, thyem* etj.

Diftongu *ie* ka qenë rezultati normal i një *e*-je më të vjetër. Zhvillimi i tij është i ndërlikuar. Përveç një shndërrimi sporadik prapavajtës (*dhe*’t për *dhjetë, dhjetë*), rruga kryesore e zhvillimit ka çuar në ruajtjen e diftongut në të gjitha pozicionet ose në disa prej tyre – ose diftongu, meqë ishte i theksuar në pjesën e parë, shndërrohej në grupin zanor *ie*, i cili më pas (përmes fazës *ië*) mund të rrëgjohej më tej dhe më në fund të bëhej një \bar{i} e gjatë. Kjo rrugë e përgjithshme zhvillimi ka qenë përvijuar nga Çabej⁴⁷, ndërsa Dodi e Gjinari, me shkallë të

⁴⁷ Çabej 1958 (1973m 128 v.).

ndryshme detajesh, janë marrë me pikat kryesore që lidhen me përndarjen e sotme të *ie* (*je*), *ië*, *ī*. Skaji jugor e ka grupin zanor *ie* në të gjitha pozicionet. Sipas hulumtimeve të Shkurtajt në të folmen gege të Kelmendit, gjendja duket të jetë e ngjashme edhe në skajin më verior, megjithëse detajet janë disi të paqarta në disa pika⁴⁸. Në pjesën tjetër të truallit gjuhësor shndërrimi i *ie* në diftongun ngjithës *je* (përgjithësisht e shkruar *je*) ose në një grup zanor (dhe më pas në *ī*) ndodh në rrugë që janë përvijuar në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Për sa i përket shndërrimit të *ie* në *ī*, krejt i zakonshëm në gegërishte, Dodi pohon se ai ndodh në emra si *mīll*, *dīll*, *qīll*, ndërsa *je* ruhet në forma foljore si *bjen*, *m(b)jell*, *pjell*, *sjell*, *vjel*⁴⁹. Sipas Gjinarit atje ka një monoftong të gjatë në forma foljore si *zīj*, *bī* dhe në forma emërore si *dīll*, *e dīl*, *mīll* (meqenëse folje si *mbjell*, *vjel* janë identike në shumicën e dialekteve, ky autor i heq ato nga hulumtimi i tij). Një zonë e toskërishtes qendrore ka *je* në të gjitha pozicionet (një situatë me sa duket e panjohur për gegërishten), por toskërishtja veriore ka *je* në trup të fjalës, ndërsa në rrokje të hapur fundore shndërrohet në grupin *ie*⁵⁰. Dodi jep një paraqitje pak më të ndryshme të fakteve. Sipas tij foljet kanë grupin *ie* në fund të fjalës: *bjer*, *mbjell*, *nxjerr*, *sjell*, *shtjer*, *vjel* dhe kur rrokja është e hapur brenda fjalës: *bjere*, *mbjellim*, *nxjerrim*, *sjellim*, *shtjere*, *vjelim*; emrat kanë grupin *ie* në rrokje të mbyllura përpara një sonanteje: *diell*, *miell*, *fier*⁵¹. Duket se detajet nuk janë krejt të qarta. Por kaq duket të jetë e sigurt: në rrokje fundore kundërvënia e hapur : e mbyllur, të paktën te foljet, ka qenë faktori vendimtar në përndarjen e *ie* : *je* – jo vetëm në disa forma të toskërishtes por edhe në të folmet gege të skajit verior. Sipas Shkurtajt, në Kelmend gjenden raste si (*unë*) *bie*, (*ti*, *ai*) *bjen* me gjithë faktin se kjo periferi gjuhësore përndryshe ka mjaft rregullisht *ie* në të gjitha pozicionet⁵².

Rrethanat në gegërishten e Budit siç është pasqyruar ajo në SC janë larg së qeni të qarta. Arsyeja kryesore për këtë është drejtshkrimi i tij i paqëndrueshëm. Shkronjën *j* ai e përdor vetëm në kombinimin *ij* (i cili zakonisht riprodhon një *ii* të gjatë). Për tingullin *i* (*j*) ai përdor *y*. Por së pari ai nuk e bën këtë rregullisht, dhe së dyti, ai (ose radhitësi) në një numër rastes ka shkruar *y* atje ku duhej pritur një *ij*. Ne nuk kemi gjetur shembuj me *ij* në pozicione ku duhej pritur *ie*. Nga ky fakt ne nxjerrim përfundimin se shndërrimi *ie* > *ī* nuk kishte filluar ende në kohën e Budit. Kjo përkon me vërejtjet e Çabejt, dmth. që monoftongimi nuk kishte filluar deri në gjysmën e

⁴⁸ Shkurtajt 1975, 27.

⁴⁹ Dodi 1970, 65.

⁵⁰ Gjinarit 1970, 40-41.

⁵¹ Dodi 1970, 65.

⁵² Shkurtajt 1975, 27.

parë të shek. XVIII dhe duket të ketë përfunduar në fillim të shek. XIX⁵³. Gjithsesi, kuptohet vetiu se mbi bazën e drejtshkrimit të Budit ne nuk mund të vendosim nëse ai ka përdorur një shqiptim *ië* a diçka të ngjashme me të – një stad zhvillimi që, siç mund të supozohet, duhet të jetë një hallkë e ndërmjetme e padëshmuar midis *ie* dhe *i*.

Nëse *ie* në tekstin e Budit ka qenë një diftong apo një grup zanor, nuk mund ta themi me siguri të plotë në shembuj si *diell*, *qiell*, *ditë* e *diellë*. Megjithatë, është e qartë se drejtshkrimi i tij duhet ruajtur në një transkriptim modern. Nga ana metrike *ie* llogaritet si dy rrokje, khs.

Q Nchielfcit ndimayone (403.2)

O, n qiellshit ndima jonë

1 23 4 5 6 7 8

Kedel Dielli errij (404.21)

ke del dielli e rrii

1 2 34 5 6 7 8

Vign bie ppara t88 (4-6.5)

vinj bie përpara tyy

1 23 4 5 6 7 8

Mosbieme ndemenij (403.7)

mos biemë ndë mënii

1 23 4 5 6 7 8

Tebiene pndeyefe (404.20)

të bienë për ndëjesë

1 23 4 5 6 7 8

Në mënyrë të ngjashme *ye* e Budit duhet mbajtur dhe transkriptuar *je* në shembuj si *tyeter* (*tjetër*), *vdyerre* (*vdjerrë*) etj. Gjithsesi duhet ta kemi të qartë se cilësia e saktë fonetike e tingullit të dhënë këtu si *y* është e hapur për hamendësime. Metrikiisht *ye* (*je*) llogaritet si një rrokje e vetme, khs.

Tyeterine megeuom (404.28)

tjetërinë me gëzuom.

1 2 3 4 5 6 7 8

Imyeri fecam fey8em (406.2)

i mjeri, se kam fëjyem

1 2 3 4 5 6 7 8

Variacione drejtshkrimore të rastit si *tieter*, *vdierre* na japin të kuptojmë se rezultatet e diftongut në shqiptimin vetjak të Budit, ose më mirë në *koinenë* gege që ai synonte, jo medoemos ishin krejt të qëndrueshme. Shembuj kryesorë

⁵³ Çabej 1958 (1973, 133-134).

si *tyeter* ndoshta duhen mbajtur si *tieter* në transkriptim, duke lënë *tjetër* si lexim të mundshëm. Se sa të pasigurt jemi mbi drejtshkrimin e SC, kjo del nga fjala *n'jerii*, e cila zakonisht shkruhet *nyerii* por jo rrallë edhe *nierii*. Kjo trajtë e fundit duhet mbajtur si *nierii* në transkriptim. Ndoshta kjo është thjesht një tjetër grafi e *n'jerii*; por nuk mund të jemi të sigurt për këtë: trajta të sotme si *nieri*, *nīri* sugjerojnë se ndoshta grafia e Budit duhet marrë ashtu siç është.

Grupi zanor *oe* i shqipes së përgjithshme nuk ka qenë një diftong i mirëfilltë. Ai dilte vetëm në një numër shumë të kufizuar leksemash dhe është zhdukur nga shumica e dialekteve të sotme duke u zëvendësuar me *e* përmes kontraksionit⁵⁴.

Të folmet e gegërishtes janë nganjëherë shumë konservative përderisa grupi *oe* është ruajtur në disa lokalitete në veriperëndim (Zadrimë) si dhe në verilindje (Prishtinë); *oe* shfaqet gjithashtu në Rekë (Dibër). Në këto vende gjejmë p.sh. *voe*, *roe* ose *oroe* e të tjera si këto. Por këto janë raste të veçanta, pasi monoftongimi ka përparuar mjaft në shumicën e të folmeve geqe. Me një shtrirje të konsiderueshme trualli veriperëndimor ka [ø:] ndërsa gegërishtja verilindore shpesh e zhvillon *oe* në *o* (p.sh. Gjakova). Gegërishtja jugore (si edhe mbarë toskërishtja) ka *oe* > *e*; të paktën sa u përket të folmeve toske ky zhvillim është i vjetër; duket se ai ka përfunduar përpara migrimeve⁵⁵.

Grupi *oe* shfaqet shumë më tepër në gjuhën e autorëve të vjetër gegë nga Buzuku te Bogdani. Fjala *voesë* del në të gjitha veprat e Budit – në SC p.sh. *posicuur*, *brðma*, *oovoesa emengiefenejc* 206.25 *posikuur bryma oo voesa e mengjesënësh*. Fjala *voe* përdoret në: *gnie cochie voe* 86.15 *një koqe voe*, – *Arrese evoefe vecefe i ha gevoyene* 200.24 *arrësë e voesë veçëse i ha gëvojënë* (del edhe në Rituale Romanum). Fjala *roe* shkruhet shumë shpesh në këtë mënyrë në SC të Budit: *bucurtue vuumroë* (sic!) 19.19 *bukur tue vuum roe*, – *mire vuum rroe* 141.6 *mirë vuum roe* etj. Kjo është vërejtur nga Çabej, i cili mendon se grafia *ree* mund të jetë thjesht gabim shtypi⁵⁶. Ne nuk pajtohemi me të në këtë pikë. Ndoshta *roe* është grafia më e shpeshtë, por megjithatë *ree* del kaq shpesh në SC saqë nuk mund të shpjegohet thjesht si një gabim shtypi i radhës. Përkundrazi, *ee* (dhe jo *oe*) duhet të kenë qenë në fakt shqiptimi i vetë autorit; khs. *forte veneree* 28.11 *fortë* (d.m.th. *fort të*) *venë ree*, – *epo iveeree* 36.5 *e po i vee ree*, – *pfepa ucutyo e veneree pakefe* 48.30 *përse pa u kujto e venë ree pakëzë* etj. (khs. p.sh. 61.19, 80.19, 81.14, 81.28, 95.6, 132.11). Dy shembuj janë gjetur në poezitë e fundit në libër: *Ndevetehe vuna ree* 406.22 *ndë vetëhe vuna ree* (që bën rimë me *dhee*). – *Andey paveniree* 407.17 *andey pa*

⁵⁴ Çabej 1958 (1973, 143 v.).

⁵⁵ Çabej 1958 (1873, 143 v.); Gjinari 1970, 41. Një *ë* e kontraktuar shfaqet që te Matrënga: *duratigliæ e dreese tinæzot* 41 v. 4 *dreessë* (që i përket : *droe-s*); Sciambra 1964, 80; 211.

⁵⁶ Çabej 1958 (1973, 145).

veni ree (që bën rimë me *rreee*). Fjala *droe* “frikë” del në: *epaa ndoognie frike, oodroetmundgnie mescuom* 144.20 e *paa ndoonjë frikë oo droe të mundnjë me shkuom*. Forma e lidhore *doe* përdoret në raste të ndryshme, p.sh. *ecuurtedoe* [1.11] e *kuur të doe*, – *temos doemey scerb8em* 113.29 të *mos doe me j shërbyem*, – *cufcte doe meeboom* 298.6 *kush të doe me e baam* e të tjera. Përkundrazi, lidhorja *thoetë* shkruhet me *ee* në: *chitemosççeete tevertetene* 310.30 *qi të mos theetë të vertetënë*.

Siç shohim, nuk ka dyshim se Budi ishte konservativ për sa i përket grupit *oe*, por në radhë të parë ai ishte konservativ në drejtshkrimin e tij. Në shtrirje të gjerë ai shkruante *oe*, ndoshta sepse ndiqte ndonjë traditë bashkëkohore dhe sepse njihte të folme ku ky grup ruhej ende si i tillë ose ishte zhvilluar ndërkaq në [ø:] a diçka të ngjashme, të cilën ai zgjodhi ta shkruante në mënyrën tradicionale. Por shembujt e shumtë me *ee* (të përdorura shumë shpesh sidomos në fjalën *ree*) tregojnë se në fakt Budi vetë e shqiptonte atë si një monoftong të gjatë. Kjo vlen edhe për ato raste ku foljet e të ashtuquajturit zgjedhim i parë (tipi *punoj*) në mënyrën urdhërore bashkohen me kundrinën përemërore enklitike. Në njërin anë gjejmë p.sh. *beecoe scpijrtijm tenezotne* 214.11 *beeko e, shpiirti im, Tenëzotnë*; por nga ana tjetër shembuj si: *Kete vepere forzee* 407.18 *këtë vepërë force e zbulojnë shqiptimin real (këtu force e bën rimë me prej tee)*. Një tjetër provë e shqiptimit të Budit të *oe*-së si *ee* është se *oe* përdoret nganjëherë atje ku do të prisnim *ee*: p.sh. *ndeevone* e shkruar *ndoe vone* 161.23, *ndoevone* 230.7⁵⁷.

Grupi zanor *ae* (po ashtu si *oe*) nuk ka qenë një diftong i mirëfilltë. Ai ishte i pranishëm vetëm në disa leksema dhe më vonë u zhduk nga të folmet gege. Gegërishtja veriperëndimore e zhvilloi këtë grup në një [ä:] të gjatë, ndërsa gegërishtja verilindore në [a:]; pjesa tjetër e truallit të gegërishtes (si dhe toskërishtja) e zëvendësuan grupin me një *e* të gjatë (nganjëherë të dhënë si *ē*). Kjo vlen edhe për dialektet e folura në Greqi e në Itali⁵⁸.

Në këtë drejtim gjuha e Budit (ose më mirë drejtshkrimi i tij) nuk është konservative por me *ee*-në e saj pasqyron gjendjen e gegërishtes jugore. Lënda është shumë e paktë por nuk lë dyshim se në gjuhën e autorit ka ndodhur shndërrimi *ae* > *ee*. Duke pasur parasysh *ngee* (nga më e hershmja *ngae*, që haset ende në librin e Buzukut) Çabej mendoi se kjo trajtë e fjalës siç është përdorur në *Dottrina Christiana* pas gjase i detyrohej kërkesave të rimës. Por është e qartë se nuk është ky rast: si gjegjëse të *Caadaleçç eperngee* që Çabej e citon nga DC, kemi në SC: *caadaleç ep ngee* 147.29, *pocaadaleç ep ngee* 150.10. Vërtet se këtu kemi të bëjmë me një shprehje frazeologjike (që i

⁵⁷ Për fjalët *voe* “vezë” dhe *voesë* “vesë” hasen forma interesante në Mat: *voe*, *vo* (trajta e shquar: *vöja*), – *voes*, *vos*. Për Gur të Bardhë jepen këto forma: *ue* - *ues*. Shih Beci 1962, 252-253.

⁵⁸ Çabej 1958 (1973, 144).

përgjigjet gjermanishtes *in aller Ruhe* ose, ndoshta edhe më mirë, danishtes *i ro og mag*), por kërkesat e rimës janë jashtë diskutimit. Budi e shkruan trajtën e vjetër të lidhores *mbae* rregullisht si *mbee*: *taruo gnie, eta mbee, mſcehune, kete caffce* 16.6 *ta ruonjë e t a mbee mſshehunë këtë kafshë, – ti mbeemend fyaletë* 28.11 *t i mbee mend fjalëtë, – muna mbeevete* 90.11 *mun a mbee vetë*. Trajta e aoristit *rae* është shndërruar në *ree* në shembullin: *po ree mboh empſceha gnia mpcat* 312.1 *po ree mboh e mpsheha nja mpat*.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Përktheu: **Anila Omari**